# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7378 E shtunë 9 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Opinioni i Ditës

Nga NATASHA MULAJ

## Të zhduken presioni dhe pesha e pushtetit politik



Qysh prej miratimit në parlament të strukturave tona të vetingut, është folur dhe komentuar pafund për rëndësinë jetike të tij, si për vetë ...

Vijon në faqen 12



Opinioni i Ditës

Nga ADRI NURELLARI

## Instalimi standardit të urrejtjes e dhunës në politikën e Kosovës

Problemet e përditshme dhe sfidat e të ardhmes së afërt me të cilat ballafaqohet populli i Kosovës shpesh e bëjnë të vështirë që të reflektohet mbi zhvillimet ...

Vijon në faqen 22




ALUIZNI: Emrat e sipërfaqet e qytetarëve që kompensohen

# Pronarët, lista e re me 456 përfitues në të gjithë vendin

Vendimi i Këshillit të Ministrave: Ndahen 240 tapi për ata që ndërtuan pa leje

Nga ORNELA MANJANI

ALUIZNI publikon listën me 240 personat që kanë ndërtuar pa leje dhe marrin tapitë për parcelën ndërtimore dhe 216 pronarët që u është prekur tona nga ndërtimet pa leje dhe marrin kompensimin për truallin...

Në faqet 18-21

HERONJTE E AJRIT, FLET KOMANDANTI I BAZES NE FARKE: MISIONET TONA TE SHPETIMIT

# SHPERBLIM PER USHTARAKET, RAMA: DO RRISIM DHE PAGAT

Kolonel Kute Hasani: Rasti më i vështirë, nxjerrja me vinç e qytetarëve të izoluar nga uji. BE e Serbia ndihma për të përmbyturit



*(Në foto)* Kolonel, Kute Hasani. Dje në garnizonin "Skënderbej" në aktivitetin "Faleminderit, Forca të Armatosura"

Në faqet 2-3-7

"STUDIO E HAPUR"

## Topalli: Basha dhe Rama janë bashkë, duhet '8 Dhjetori' i 2-të për t'i përmbysur

Në faqen 6

DEKANI I RI

## Zgjedhjet te Histori-Filologjia, kandidatët akuzojnë njëri-tjetrin për manipulim votash

Në faqen 10

ARRATISJA

## Amerika dëbon Lucaj, historia e shqiptarit që u dënua me 14 vite burg për vrasje

Në faqen 8

REPORTAZH

## Në Urgjencën e QSUT, mes dyndjes së pacientëve e punës së palodhur të mjekëve

Në faqen 9

MESAZHET E KODUARA TE ENIT, SALSANO NE GJYQ




## 'Kënga magjike', ja 3 kandidatët për finalen, thashethemet në rrjete, flet Nevina Shtylla

Suplement

8 DHJETORI/ Mesazhet e presidentit, kryeministrit e kreut të PD për rininë

# "Lëvizja e dhjetorit kishte muaj që përgatitej"

*Bardhyl Londo: Radikalët e Lidhjes, "Thirrjet e Gjakut" më rrezikuan*

Nga VALENTINA MADANI

Bardhyl Londo, shkrimtari i njohur, ish-deputet i PD-së hedh dritë mbi shumë ngjarje zinxhir, të cilat sipas tij çuan në rrëzimin e diktaturës komuniste në Shqipëri. Z.Londo thotë për "Gazeta Shqiptare" se lëvizja e dhje-





torit ishte veçse kurorëzimi i një përgatitjeje të gjatë nga intelektualë të ndryshëm, të cilët jo rastësisht më vonë, në dhjetor të '90-ës u identifikuan si 'pardesytë e bardha'. Revoltën e tij ndaj diktaturës, Londo e shfaqi më herët, diku në prill të '90-ës...

Në faqet 4-5

# BAZA AJRORE E FARKES

## 50-VJETORI

"Shpërblimet me VKM, sa vlera e pagës. Kemi sigurim jete"

# Heronjtë e ajrit, Hasani: Si i shpëtuam të përmbyturit

## "Rasti më i vështirë, nxjerrja me vinç e qytetarëve"

Ina Allkanjari

*Prej 30 vitesh ai jeton mes ajrit e tokës, në shërbim të qytetarëve që gjenden në vështirësi të mëdha. Sot është komandant i bazës ajrore të Farkës, por fluturimi për të është adrenalinë. Në mes të rrezikut apo rehatllëkut, ai zgjedh gjithnjë të parën, sepse të shpëtosh jetë njerëzish për të ka vlerë të pakrahasueshme. Në 50-vjetorin e krijimit të kësaj baze ajrore, e vetmja në Shqipëri, kolonel Kuto Hasani na rrëfen misionin më të fundit të djemve të tij për shpëtimin e qytetarëve nga përmbytjet e fundnëntorit e fillimdhjetorit 2017, vështirësitë, pamundësinë ndonjë rast për shkak të kushteve atmosferike, por edhe lajmin e mirë që puna e heronjve të ajrit shpërblehet...*



Komandanti i Bazës Ajrore të Farkës, kolonel Kuto Hasani

**EMERGJENCAT**

Situata të tilla nuk janë të panjohura për procedurën normale të punës sonë. Veçoria në situata të tilla ka të bëjë me vështirësinë e misionit, vështirësinë e detyrës që do të kryesh, sepse je në një situatë që kërkon të veprohet shumë shpejt dhe shumë saktë.

**Zoti Hasani, pak ditë më parë ishte 50-vjetori i krijimit të bazës ajrore, që përkoi me 105-vjetorin e formimit të ushtrisë shqiptare. Si ishte ceremonia e organizuar me këtë rast?**

Fatmirësisht 105-vjetori i formimit të ushtrisë shqiptare rezultoi të ishte në të njëjtën ditë me 50-vjetorin e krijimit të bazës ajrore të farkës. Në këtë kuadër, organizimi ishte i përbashkët. Filloi në datën 5 dhjetor me ceremoninë e organizuar në sheshin "Nënë Tereza", nga autoritetet më të larta të shtetit shqiptar, duke filluar nga presidenti, ministri i Mbrojtjes dhe personalitete të tjera. Ishte një organizim shtetëror dhe në këtë kuadër u fut dhe 50- vjetori i bazës. Në këtë aktivitet Baza Ajrore Farkë u nderua me medaljen "Repart i Shquar", akorduar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

**Forcat Ajrore u angazhuan javën që shkoi për të ndihmuar banorët e zonave të përmbytura. A ishit të përgatitur për të përballuar situatën e rëndë që u shkaktua nga reshjet?**

Situata të tilla nuk janë të panjohura për procedurën normale të punës sonë. Veçoria në situata të tilla ka të bëjë me vështirësinë e misionit, vështirësinë e detyrë që do të kryesh, sepse je në një situatë që kërkon të veprohet shumë shpejt dhe shumë saktë. Situata e fundit nuk na gjeti të papërgatitur, sepse ne kemi një eksperiencë disavjeçare. Fatkeqësisht, situata të tilla jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon po përsëriten shpesh, por ne jemi plotësisht të përgatitur si për përmbytjet për situatat e bllokimit nga bora, edhe për emergjenca të tjera. Uroj që mos të kemi tërmete, sepse ato janë shumë fatale dhe ne nuk kemi shumë përvojë. Por në të gjitha llojet e emergjencave të tjera, aksidentet ajrore, tokësore, detare ne kemi një eksperiencë të admirueshme dhe stafet janë të trajnuara.

**A janë trajnuar efektivët e Forcave Ajrore për të përballuar fatkeqësitë natyrore?**

Ne kemi një privilegj që trajnimi, certifikimi bëhet gjithmonë jashtë shtetit. Unë si komandant jam më komod se homologët e mi për të përcaktuar efektivin, mjetet dhe për t'i dalë për zot situatës, sepse i kanë kushtet në një nivel më të lart se të tjerët. Është marrë eksperienca më e mirë botërore, është shpenzuar lekë nga shteti shqiptar për t'i falënderuar këta njerëz në këto lloj emergjencash, në mënyrën më të mirë të mundshme.

**Çfarë masash morët në lidhje me përmbytjen?**

Rasti i fundit i përmbytjeve fatmirësisht zgjati për një periudhë të shkurtër kohore. Ne morëm masat dhe vendosëm në dispozicion 4 helikopterë. Një helikopter ishte i mirëfilltë për emergjenca mjekësore, i cili u angazhua jo më pak se dy raste gjatë kësaj situate. Vendosëm në gatishmëri dy helikopterë 'Cougar', në variantin transport civilësh dhe mjetesh për ndihmë nga ajri dhe një helikopter 'Ec145' në varianti "kërkim dhe shpëtim". Pjesën tjetër i vendosëm në gatishmëri në repart, në qoftë se do kishim emergjencë më madhore.

**Ku konsistoi ndërhyrja e Forcave Ajrore?**

Angazhimi konsistoi kryesisht në inspektime nga ajri dhe në kontrolle të situatave që kërkonin ndërhyrje emergjente. Kulmi i të gjithë operacionit pjesëmarrës ishte me ndërhyrjen që bëmë me helikopterin 'EC145' për të nxjerrë njerëzit nga shtëpitë e përmbytura me vinç.

**Cilat ishin vështirësitë që hasët gjatë evakuimit të banorëve?**

Hasëm dy raste të vështira dhe në një mision dështuam. Ditën e parë patëm një emergjencë civile të një ushtaraku të Forcave të Ndërlidhjes, i cili duhet të shkonte në Gllavë. Gjatë situatës së përmbytjes u rrëzua një pemë sipër një makine. U bë e pamundura, fillimisht u nis njëri prej helikopterëve, por për arsye të mjegullës dhe erës së jashtëzakonshme nuk u ul dot tek zona e antenave në Dajt. Pas një ore, duke qenë se po vonohej nxjerrja e personit, ndërhymë prapë me helikopterë të ushtrisë 'EC145'. Në këtë mision kam qenë vetë pilotë së bashku me zëvendëskomandën e grupit të 'EC145'. Tentuam dy herë të uleshim në rrugën kryesore të Dajtit, por ishte e pamundur për shkak të erës, e cila kaloi mbi 40 km në orë. Ndërkohë që Rinasi i bllokoi fluturimet ne ishim në ajër dhe eprorët tanë kaluan në alert. Ne bëmë detyrën tonë, por nuk mundëm të ndërhynim. Në këtë mënyrë, personi i bllokuar u transportua në linjë tokësore me ambulancat e ushtrisë dhe u dërgua në spital.

**Po gjatë misionit tuaj, patët raste të kundërshtimit të banorëve të prekur nga përmbytja për të mos u evakuuar nga banesat e tyre?**

Në rastin e dytë ndërhymë në zonën e Fushë-Krujës dhe u nxorën nga shtëpitë 11 persona. Ditën tjetër që përmbytja kaloi në zonën e Vlorës, përsëri i angazhuam të dy helikopterët 'Cougar' dhe 'EC145', por nuk patëm detyra konkrete, ishte inspektim, vlerësim. Ndërhymë në një situatë, por u hasëm me një problem, sepse civilët që ishin në zonën e rrezikuar nuk pranuan të hipnin në helikopter për shumë arsye. Dikush dëshiron të ruajë banesën, dikush tjetër mund të ndjejë frikën e shpëtimit nga ajri. Në këtë pikë kërkesa ime si komandant është mirëkuptimi që duhet të kemi me civilët. Ne ndërhyjmë atje ku rreziku është i madh dhe është e paimagjinueshme që disa civilë nuk e pranojnë këtë lloj ndërhyrjeje. Duhet të respektojnë të gjithë sakrificën tonë për t'i shpëtuar dhe duhet të kuptojnë që në momentin që ne ndërhyjmë, është me të vërtetë një situatë rreziku.

**Kur zë fill lidhja juaj me aviacionin?**

Unë i takoj brezit të ushtarakëve që relativisht quhemi të vjetër. Jemi një brez që kemi jetuar dhe punuar gati 30 vjet në Forcat Ajrore si pilotë. Përvoja ime dhe lidhja me aviacionin ka filluar që prej vitit 1985, me përfundimin e shkollës së aviacionit, që në atë kohë ishte në Vlorë. Me përfundimin e shkollës, një pjesë e jona, përfshirë edhe mua, qëndruam instruktorë për pilot pranë kësaj akademie, duke përgatitur breza pilotësh. Detyrë të cilën e kreva për jo më pak se 12 vjet deri në vitet 2002. Më vonë u morën vendimet politike për ndërprerjen e fluturimeve me avion reaktiv në Republikën e Shqipërisë dhe detyrimisht u vendos sistemi i ri i fluturimit, helikopterët. Më vonë kalova shef operacional në bazë, më pas shef shtabi në bazë, shef i sigurisë së fluturimit në Forcën Ajrore, shef i shtabit të Forcave Ajrore, detyrë të cilën e kisha deri në vitin 2014. Tani mbaj pozicionin e komandantit të Bazës Ajrore të Farkës.

**Cili është historiku i Bazës Ajrore të Farkës?**

Në dhjetor të vitit 1967, Baza Ajrore e Farkës ka mar-



Dje në garnizonin "Skënderbej" në aktivitetin "Faleminderit, Forca të Armatosura"

## Major Valentina Korbi: Ditët e fluturimit i ndjekim me përkushtim dhe shqetësim

Major Valentina Korbi është bërë pjesë e Forcave të Armatosura Shqiptare që në shtatorin e vitit 2004. Majorja thotë për "Gazeta Shqiptare" se sapo është emëruar në detyrë, ka punuar në administratën e Bazës Ajrore Farkë. "Prej 13 vitesh unë punoj në këtë bazë dhe shprehem entuziaste dhe me krenari që jam pjesë e saj. Kjo për vetë faktin e misionit dhe detyrave që kjo bazë përmbush. Momentalisht mbuloj detyrën e shefes së Sekretarisë së Bazës. Është një detyrë e bukur, por që gjatë gjithë kohës je në kontakt me informacionin, por edhe me personelin", u shpreh Valentia Korbi. Gjithashtu,



Major Valentina Korbi

ajo tregon se gjatë gjithë karrierës së saj ka pasur bashkëpunimin dhe mirëkuptimin me kolegët. Korbi thekson se personeli i Bazës Ajrore Farkë karakterizohet nga marrëdhënie shumë të mira me njëri- tjetrin, kjo për vetë natyrën e misionit dhe detyrave që realizohen. "Ditët e fluturimit i ndjekim të gjithë me të njëjtin përkushtim dhe shqetësim. Të mos flasim pastaj për fluturimet që zhvillohen në kushte të vështira meteorologjike. Së pari, është shqetësimi i realizimit të misionit, por edhe duke u kthyer shëndoshë e mirë të gjithë ekuipazhet fluturuese. Nisur nga gjithë ato misione në operacione humanitare apo Emergjenca Civile, edhe unë si pjesë e tyre ndjehem krenare që punoj me ta. Gjithashtu, nuk kam hasur asnjëherë probleme me kolegët, kjo për faktin se unë jam natyrë bashkëpunuese dhe mirëkuptuese. Xhentilesa e ekuipazheve fluturuese ka mbizotëruar në çdo moment", tha për "GSH" major Valentina Korbi.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### Xhaçka, medalje 7 reparteve të FA në përballimin e situatës së reshjeve

# Qeveria shpërblen ushtarakët për përmbytjet. Rama: Rriten pagat në 2019

## *Numri i përfituesve dhe masa e shpërblimit caktohen të mërkurën*

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje, rritje të konsiderueshme pagash për ushtarakët në vitin 2019. Gjatë fjalës së mbajtur në aktivitetin "Faleminderit, Forca të Armatosura", organizuar në garnizonin "Skënderbej", në Ministrinë e Mbrojtjes, Kryeministri iu drejtua ushtarakëve me fjalët: "Krahasuar me kolegët e tjerë pagat tuaja janë të ulta dhe pavarësisht nivelit të lartë profesional dhe dijes patriotike që ju mishëroni, ne nuk kemi arritur dot t'ju shpërblejmë ashtu siç e meritoni. Dhe ne nuk kemi arritur të mbyllim hendekun mes jush dhe Policisë së Shtetit, i cili kurrë nuk mund të arrijë deri aty ku ju e meritoni". "Sot,-tha më tej Rama, qeveria do të vendosë në radhë të parë një shpërblim si shprehje mirënjohjeje për të gjithë ata që u përfshinë në operacionin fantastik që shteti përballoi si shprehje e rëndësishme". Mësohet se janë mbi 2 mijë ushtarakë të angazhuar gjatë ditëve të përmbytjeve, por nuk dihet se cila pjesë e tyre do të shpërblehet. Vendimi pritet të merret të mërkurën në mbledhjen e radhës së qeverisë. "Dua të angazhohem sot që viti 2018 do jetë viti i fundit për të cilin buxheti i shtetit do të ketë rrogat ekzistuese për ju. Ne jemi shumë të vendosur të rrisim buxhetin e ushtrisë dhe në kuadrin e angazhimeve si anëtarë të NATO-s, gjë që e kemi bërë në buxhetin e viti 2018. Por rritja do të vazhdojë, dhe e para rritje prioritare për vitin 2019, do të jetë rritja e konsiderueshme për të gjitha pagat e ushtarakëve",-theksoi kryeministri. Sipas tij, "Kjo rritje nuk ka ndodhur deri tani, jo se nuk do të kishim dashur ta bënim më shpejt, apo se nuk do të kishim dashur më parë, por se kjo lidhet me faktin e thjeshtë se gjithçka që duam nuk është e mundur kur duam dhe duhet, por kur ne mundemi". Për shkak të përmbytjeve 105-vjetori i krijimit të FA nuk u arrit të festohej siç duhej, tha ndër të tjera, Rama, duke i uruar ushtarakët. "E gjithë Shqipëria e ndoqi me shqetësim dhe e pa me admirim të gjithë përpjekjen në zonat e përmbytura, ashtu siç mundi të shohë fare pak nga pamjet dhe aktet e angazhimit të strukturave të FA në përpjekjet e pakursyera për të shpëtuar jetët njerëzore përballë egërsisë së ujit",-u shpreh Rama, duke falënderuar edhe vendet e rajonit për ndihmat e dhëna në këtë situatë. Rama uroi dje, edhe Ditën e Rinisë.

Falë angazhimit të mijëra efektivë dhe qindra mjeteve të tokës dhe ajrit Forcat e Armatosura (FA) arritën të evakuojnë 598 familje dhe të shpëtojnë 1552 persona në të gjithë vendin nga përmbytjet e mëdha që prekën vendin javën e kaluar, duke superuar në kohë rekord vështirësitë e situatës së krijuar. Në ceremoninë e mirënjohjes së FA në përballimin e situatës së përmbytjeve që u organizua të premten në Tiranë, ku merrte pjesë kryeministri Edi Rama, ambasadori amerikan Donald Lu, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka tha se, "FA do të jenë në shërbim të atdheut edhe në ditë më të vështira dhe një organizim edhe më i mirë na pret në vitet e ardhshme". "FA do vazhdojnë të jenë në krye të detyrës, ditë dhe natë. Na pret një organizim dhe më i mirë në vitet e ardhshme, pasi Emergjencat Civile janë nën FA. Specialistët tanë nuk do jenë në terren vetëm për të menaxhuar emergjencat, por edhe për të bërë analiza",- tha Xhaçka. Ministrja Xhaçka nderoi Repartin e Farkës, bazën e Mbështetjes Rajonale dhe Xhenios. Ajo, gjithashtu, i dha medalje për kontribut të shquar, Batalionit të këmbësorisë Poshnjë, reparti ushtarak 5010. U nderuan me Medaljen e Luftëtarit për pjesëmarrje në misionet ushtarake batalioni Komando, reparti ushtarak 1020 dhe batalioni i dytë i këmbësorisë.



Kryeministri Edi Rama dhe ministrja, e Mbrojtjes Olta Xhaçka, dje në garnizonin "Skënderbej"

**DEKLARATA**

Ne jemi shumë të vendosur të rrisim buxhetin e ushtrisë edhe në kuadrin e angazhimeve si anëtarë të NATO-s, gjë që e kemi bërë në buxhetin e viti 2018. Por rritja do të vazhdojë dhe e para rritje prioritare për vitin 2019 do të jetë rritja e konsiderueshme për të gjitha pagat e ushtarakëve", - theksoi kryeministri.

## Mbledhja e qeverisë, Rama batuta me Ademin: Me durim po afrohemi

Qeveria u mblodh dje, në Shkodër ku ka marrë disa vendime që kanë të bëjnë me këtë qytet. Në një dalje për mediat, pas mbledhjes, kryeministri Rama njoftoi se është miratuar vendimi për shpalljen e qendrës historike të Thethit dhe zonës përreth, një vendim ky që përputhet me nevojën për të investuar më shumë burime financiare në këtë zonë, duke filluar nga rindërtimi i rrugës së Thethit. Një tjetër vendim i komunikuar nga shefi i qeverisë ka qenë ai për miratimin e bursave të shkollës së mesme profesionale, që në total janë 84 dhe do të shkojnë për nxënësit familjet e të cilëve janë në vështirësi financiare. Më vonë Rama ka zhvilluar edhe një takim me studentët e ekselencës, me të cilët ka diskutuar për Ditën e Rinisë. "Nuk ka tapet të kuq për në qeveri. Qeveria shqiptare do të bëjë më shumë nëse ka shtysa të reja që duhet të vijnë nga ju",- u ka thënë ai të rinjve. Më herët Rama inspektoi punimet për rrugën turistike të Velipojës, ku shkëmbeu batuta me kryetaren e bashkisë Voltana Ademi. Gjatë kësaj vizite Rama ka qenë i shoqëruar nga ministri i Jashtëm Ditmir Bushati. Në fjalën e saj, Ademi tha: "Më bëhet qejfi që ministri Bushati bashkohet me ne për këto çështje teknike". "Bushati bashkohet po ti s'afrohesh",-është përgjigjur Rama. Kreu i qeverisë ka vijuar batutat me kryebashkiaken Ademi edhe kur është pyetur nga mediat nëse mund të gjendet gjuha e pajtimit me kryeministrin e Malit të Zi, që insiston që aksi Adriatiko-Jonian të kalojë nga Podgorica dhe jo nga Muriqani. "Siç e shihni durimi po na afron dhe me Voltanën, mendoni pastaj sa kollaj e kemi me Malin e Zi",-ka thënë Rama për gazetarët.

rë emërtimin dhe flamurin luftarak, pasi u pajis plotësisht me rreth 38 helikopterë. Ka qenë e vetmja bazë me helikopterë në Republikën e Shqipërisë nga viti '67 e në vazhdim dhe sot është e vetmja bazë aktive e Forcës Ajrore. Historiku i kësaj baze, me gjithë ndryshimet që ndodhën në Shqipëri, është i pandërprerë.

**Cila është veçoria e pozicionit tuaj si komandant?**

Nuk mund ta fsheh dëshirën time për fluturim, pasi është adrenalinë. Përpos përgatitjes teorike, shkollimit dhe sjelljes, në fluturim jam i detyruar ta ndjek vartësin që të kuptoj nivelin e tij si pilot. Veçoria e pozicionit si komandat ka qenë është dhe do të jetë që komandanti është edhe pilot i thjesht. Kur fluturoj, unë jam pilot. Fluturimi ka rregulla strikte, nuk ka grada. Që të bëj një vlerësim sa më real të vartësve, duhet t'i njoh ata dhe në ajër.

**Çfarë vështirësish hasni gjatë punës suaj?**

Vështirësitë e komandantit dhe të pilotit janë të ndara. Në përvojën time dhe konceptim tim, detyra e komandantit është më e thjeshtë se ajo e liderit. Profesioni ynë të vë në pozitë, sepse duhet të bësh rolin e liderit. Çka nënkupton që duhet të futesh në botën e pilotit përpara se ta urdhërosh atë, duhet të njohësh gjendjen e tij shpirtërore, financiare, problemet që ka në familje, problemet shoqërore. Te efektivi fluturues duhet të shkrihesh me të, ndryshe do rrezikosh, pasi në një moment që nuk njeh situatën, nuk njeh pilotin dhe jep një urdhër që nuk mund ta përballojë si person, atëherë i vendos jetën në rrezik. Është me të vërtet një profesion shumë i vështirë, që kërkon gjithë kohës që këta njerëz të jenë sa më në formë për ta kryer detyrën. Ky element të vendos në vështirësi si drejtues, sepse duhet ta vlerësosh në të gjithë aspektin një person. Duhet të marrim vendime sa më të sakta me personat e duhur, kjo është vështirësia e punës si komandant. Duhet të jesh i bindur që në momentin që jep një urdhër, nuk do preken elementët e sigurisë së fluturimit.

**Cili është momenti më i veçantë gjatë karrierës suaj si pilot?**

Si operacione të veçanta më vjen në kujtesë shpëtimi i një vajze në zonën e Tepelenës, ishte shtatzënë me rrezik dështimi dhe me shumë probleme, koha ishte tepër e keqe. Kjo situatë ka ndodhur rreth vitit 2007. Arritëm që vajzën ta shpëtonim, por foshnja nuk mundi të mbijetonte. Lindja filloi në ajër dhe vajza arriti të shpëtonte.

Momenti më i vështirë...

Nga viti '67 deri në vitet '90, në këtë bazë ka pasur vetëm një incident të rëndë. Më 22 nëntor 1989 humbën jetën 23 njerëz. Efektivë të Forcave Ajrore u dërguan me helikopter në të dalë të Himarës për të shpëtuar 14 studentët dhe 3 pedagogët e Institutit Bujqësor, pasi autobusi që ata udhëtonin ishte rrëzuar afërsi të Himarës. Pavarësisht vullnetit dhe dëshirës të ushtarëve të Bazës Ajrore të Farkës për të shpëtuar njerëzit, për shkak të kohës jo të përshtatshme për të kryer misionin humanitar, ata iu bashkuan të njëjtit fat, asnjë nuk mbijetoi.

**Një jetë me punë që ka shumë risk, keni sigurim jete?**

Për sa u përket ndryshimeve në paketën ligjore është realizuar siguracioni i mjeteve ajrore, është një element që nuk e kemi pasur më parë. Është i kushtueshëm, por edhe i domosdoshëm, i cili realizohet nga Ministria e Mbrojtjes çdo vit. Gjithashtu, është siguracioni i jetës së efektivit fluturues, një siguracion i veçantë jete për rrezikshmërinë e lartë që kemi në punë. Në rast incidenti, familjet janë totalisht të siguruara.

**Çfarë shpërblimi merr një efektiv kur humb jetën në detyrë?**

Në incidentin e fundit të Bazës Ajrore që u vranë dy pilotë, humbja ishte shumë e madhe, e parikuperueshme, por familjet të paktën nga ana financiare nuk e ndjejnë falë sigurimit të jetës, që është rreth 180 mijë dollarë.

**Merrni shpërblime për operacionet ajrore?**

Po marrim, kjo është vendosur nga Këshilli i Ministrave, pra pagesa për vështirësi pune për efektivin fluturues, që kap afërsisht vlerën e pagës. Nëse rroga është 40 mijë lekë të reja, atëherë dhe shpërblimi për vështirësi pune është 40 mijë lekë të reja.

**Cili është vizioni juaj si komandant për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj baze?**

Kemi tre elementë kryesorë, të cilët ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj baze. Si fillim e rëndësishme është vazhdimi i përgatitjes së gjeneratave të reja, me specialistë të Forcave Ajrore. Më pas duhet të ushtrojmë fokus te vazhdimi i programit të blerjes së helikopterëve të rinj. Rritja e numrit të helikopterëve të rinj dhe reduktimi i helikopterëve të vjetër. Gjithashtu, kemi nevojë në vijim për rregullimin e pjesës së legjislacionit përsa i përket menaxhimit të mjeteve ajrore apo dhe të shpërblimit të efektivëve fluturues.

# PERVJETORI I PD

## RREFIMI

"Reparti i 'Rrapit të Trishit', si e gjeta Berishën duke lexuar fshehurazi Dostojevskin"

# Londo: Çfarë ndodhte në Lidhjen e Shkrimtarëve, kush ishin më radikalët

## "Rreziku që më erdhi prej poemës 'Thirrjet e gjakut'"


Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje tek shtatorja e Azem Hajdarit

Valentina Madani

*Bardhyl Londo, shkrimtari i njohur, ish-deputet i PD-së hedh dritë mbi shumë ngjarje zinxhir, të cilat sipas tij çuan në rrëzimin e diktaturës komuniste në Shqipëri. Z.Londo thotë për "Gazeta Shqiptare" se lëvizja e dhjetorit ishte veçse kurorëzimi i një përgatitjeje të gjatë nga intelektualë të ndryshëm, të cilët jo rastësisht më vonë, në dhjetor të '90-ës u identifikuan si 'pardesytë e bardha'. Revoltën e tij ndaj diktaturës, Londo e shfaqi më herët, diku në prill të '90-ës me poemën "Thirrjet e gjakut", e cila mund t'i kushtonte edhe jetën. Bardhyl Londo, në atë periudhë kryeredaktor i gazetës "Drita", tregon për njohjen e parë me doktorin Sali Berisha tek reparti ushtarak i 'Rrapit të Trishit', takimet e mëvonshme në Bibliotekën Kombëtare dhe bashkëpunimi i gjatë me të në PD.*


Ish-deputet i PD-së, Bardhyl Londo

**PËR BERISHËN**

"Përfitova nga fakti që u ngrit më këmbë dhe i hodha një sy librit, ishte Dostojevski. Nuk më kujtohet në ç'gjuhë, por me siguri në rusisht. Shqip jo e jo, sepse ishte i ndaluar dhe nuk ishte përkthyer fare".

**Z.Londo, si ishte situata në Tiranë para fillimit të protestave në dhjetor 1990?**

Nga më të rëndat që ka kaluar Shqipëria kur nuk ka pasur ndonjë invazion ushtarak të huaj. Mizerjes ekonomike, radhëve të gjata nëpër dyqane për elementët më të thjeshtë të jetesës si buka dhe qumështi, mungesës së elektricitetit ose racionimit të tij u ishte shtuar edhe depresioni dhe zhgënjimi i pandreqshëm se Shqipëria është e dënuar kushedi nga çfarë fuqie e jashtëzakonshme, hyjnore apo tokësore, të mbetej gjithmonë e mjerë, larg zhvillimeve që tashmë kishin ndodhur në vendet e tjera të Evropës Lindore; të mbetej pra, si një dele e zezë në Evropë dhe pse jo, në botë. I gjithë ky dëshpërim i frikshëm ishte plotësisht i justifikuar. Regjimet komuniste kishin rënë një nga një në të gjithë Europën Lindore. Kishin rënë në mënyrë spektakolare duke ngjallur një entuziazëm dhe një shpresë plot dritë në të gjithë botën. Kënga "Wind of change" ishte bërë në një farë mënyre himn i njerëzimit. Në dhjetor të vitit 1989 ra edhe një nga bastionet më famëkeqe të historisë së komunizmit botëror, diktatura e përgjakshme e Çausheskut në Rumani. Spektaklin, por edhe përgjakjen e rrëzimit të kësaj diktature e ndoqa njëzet e katër orë pa lëvizur nga ekrani i televizorit. Natyrisht, nga televizioni jugosllav, i cili e transmetoi live të gjithë ngjarjen, sepse për Televizionin Shtetëror Shqiptar as që mund të mendohej që të jepte diçka të rëndësishme nga ato që ndodhnin në Rumani. Gëzimit të përmbysjes së diktaturës në Rumani iu shtua një trishtim dhe dëshpërim shumë i madh: Shqipëria përsëri kishte mbetur e fundit, e braktisur, e nëmur, e vetmuar, në dorë të atyre që e kishin drobitur dhe plaçkitur për gjysmë shekulli rresht. Ishte një nga situatat më depresive dhe më të dëshpëruara që po kalonte vendi ynë. U desh edhe një vit tjetër nga dhjetori i vitit 1989, në dhjetorin e vitit 1990 që revolucioni antikomunist të vinte nga Rumania në Shqipëri. Ishte paradoksalisht një kohë shumë e gjatë, ashtu siç ishte shumë dëshpëruese që Shqipëria përsëri mbeti e fundit nga vendet e Evropës, që u fut në rrugën e Zotit, siç thuhet.

A ishin shkrimet e intelektualëve gjatë periudhës prill-qershor 1990, ato që ndezën shkëndijat e para të demokracisë? Kam parasysh këtu emrat e intelektualëve që habitën opinionin shqiptar me guximin e tyre. Pa pretenduar se mund të bëj një listë përfundimtare, mund të përmend emra të tillë si ju, Ylli Popa, Sali Berisha, Kujtim Çashku etj.

Shkrime të tilla, patjetër që kanë luajtur një rol jo të vogël në ndërgjegjësimin e njerëzve, sepse para së gjithash, i ndihmonin ata të mposhtnin frikën që diktatura e tmerrshme gjysmëshekullore ua kishte injektuar në çdo qelizë të trupit. Por, rolin kryesor e luajti dikush tjetër. Komunizmi ra nga mbipesha e tij, në kuptimin që e kishte tepruar aq shumë, kishte tejkaluar çdo masë dhe hamendje njerëzore me zullumet e veta, sa nuk kishte më as Zot, as djall që ta shpëtonte dhe ta mbante më këmbë më. Dhe, e dyta, ngjarjet në vendet e tjera të Europës Lindore nuk mund të mos arrinin edhe në Shqipëri, sado e veçuar dhe e vetizoluar të ishte kjo e fundit.

**LËVIZJA**

Atëherë, me humor thoshim, "po punojmë me dy turne". Arsyeja ishte e thjeshtë, mbaronim sa më shpejt punën në gazetë dhe pastaj deri vonë rrinim në Qytetin Studenti, i cili në ato kohë ishte 'Meka' dhe 'Jeruzalemi' i shqiptarëve.

**Çfarë nënkuptonte poema juaj "Thirrjet e gjakut", botuar në gazetën "Drita", më 8 prill 1990? Si u prit ajo, cilat ishin reagimet?**

Nënkuptimin, apo kuptimin direkt më saktë, e ka që në titull, gjaku shqiptar, ai i riu, por edhe shekullori thërrisnin, ose më drejt ulërinin për ndryshim, për bashkim me Europën, për rikthimin e Shqipërisë në një vend si gjithë të tjerët. Jo rastësisht poema u botua pikërisht në përvjetorin e vdekjes së diktatorit Hoxha.

Vetë përjetova dy gjendje krejt të kundërta, frikën se mosguximin apo "marrëzinë" time, siç u shpreh një miku im, e paguaja shtrenjtë dhe të kundërtën e saj, kënaqësinë e leximit dhe përhapjes së shpejtë e të menjëhershme të poemës. Atë ditë gazeta mbaroi shumë shpejt, njerëzit e kalonin nga dora në dorë. Të tjerë kur gjenin mundësinë, e fotokopjonin për ta shpërndarë përsëri. Vonë, shumë vonë, pas shumë vitesh, shkrimtari dhe fotoreporteri i njohur Besim Fusha më dhuroi një faqe gazete të fotokopjuar ato ditë dhe që e kishte ruajtur me kujdes, ku ishte poema ime. Mbrëmjes, në sheshin "Skënderbej", ku bëhej shëtitja e famshme e atëhershme, shpesh më kapte veshi vargje nga poema. Pëlqeheshin sidomos vargjet "një aeroplan ulet/ një tjetër ngrihet", "që bënte fjalë për jetën luksoze të bllokut dhe të nomenklaturës së lartë komuniste.

**Si ndihej fundi i diktaturës në gazetën "Drita" dhe në Lidhjen e Shkrimtarëve?**

Në gazetën "Drita" ishim një grup shumë i mirë, të gjithë të lidhur me mish e me shpirt me lëvizjen antidiktaturë. Madje disa prej tyre, si Rudolf Marku, Teodor Keko, Lazër Stani, Arben Kallamata ishin aq radikalë sa duhej "t'u injektonim qetësues për t'i përmbajtur". Ne i hapëm faqet e gazetës për mendimin intelektual, duke iu hyrë në pjesë shkrimeve për letërsinë dhe artet. Ky ishte një vendim unanim, i marrë në mbledhjen e redaksisë. Në një farë mënyre, në mungesë të shtypit opozitar, e morëm përsipër ne, me sa kishim mundësi për ta kryer këtë rol. Ju përmendët me të drejtë disa shkrime dhe autorë, por unë mund të shtoj edhe emra e shkrime të tjera po aq të guximshme, madje edhe më të guximshme. Vendimi që morëm nuk u gëlltit lehtë nga pjesa e Lidhjes, që ishte e lidhur shpirtërisht dhe materialisht me diktaturën. Ata na akuzuan se po shkatërronim gazetën, duke i ndryshuar drejtimin. Argumenti i tyre ishte i vërtetë, por shumë tinëzar dhe dashakeq. Nuk e kishin fare hallin tek orientimi i gazetës, por tek cenimi i statukuosë që u kishte siguruar diktatura. Për fat të keq me këtë mendim, të ndryshimit të orientimit të gazetës bashkohej edhe një pjesë e Lidhjes, por në mënyrë krejt naive e të pafajshme; ajo pjesë që e mendonte letërsinë dhe artet si "të paprekshme", "hyjnore", "qiellore" etj., etj..

Në një farë mënyre, kjo ishte gjendja e Lidhjes në prag dhe gjatë ditëve të lëvizjes së dhjetorit. Një pjesë që e përkrahte me gjithë shpirtë, një pjesë që nuk e dëshironte, madje e urrente e iu kundërvu asaj dhe një pjesë, e cila nuk ishte as mish, as peshk dhe që notonte nëpër ujërat e mykura të letërsisë dhe artit mbi gjithçka dhe mbi këdo.

**Si e mbani mend fillimin e lëvizjes së dhjetorit dhe kur iu bashkuat asaj?**

Fillimi i lëvizjes së dhjetorit nuk besoj se ka ndonjë datë fikse. Duhet të kthehemi shumë prapa në histori dhe të kujtojmë gjithçka që përgatit atë. Dhe këtu nuk është fjala thjesht për dhjetorin, nëntorin apo tetorin. Bëhet fjalë për një kohë shumë më të gjatë. Dhjetori ishte kurorëzimi i shpërthimit të kësaj lëvizjeje, e cila kishte muaj që përgatitej, qoftë edhe në mënyrë të paorganizuar. Sidoqoftë, ka një shenjë: intelektualët që u morën me organizimin e lëvizjes së dhjetorit, nuk e di si, pse, qysh dhe nga, mbanin zakonisht pardesy të bardha. Aq shumë u bë e modës kjo ngjyrë pardesysh, sa dikush e quajti në mënyrë figurative, por edhe të goditur "Dhjetori i pardesyve të bardha". Kur iu bashkova? Atëherë, me humor thoshim, "po punojmë me dy turne". Arsyeja ishte e thjeshtë: mbaronim sa më shpejt punën në gazetë dhe pastaj deri vonë rrinim në Qyteti Studenti, i cili në ato kohë ishte 'Meka' dhe 'Jeruzalemi' i shqiptarëve.

**Si jeni njohur me z.Berisha dhe protagonistët e tjerë të lëvizjes?**

Pothuajse të gjithë i kisha takuar dhe njohur prej kohësh. Me zotin Berisha jemi takuar në rrethana që nuk harrohen lehtë, tek reparti ushtarak i 'Rrapit të Trishit', Berisha mjek i porsadiplomuar dhe unë ende student. Meqë kisha dy net që nuk më zinte gjumi, u drejtova në çadrën e infermierisë. Mjeku kishte ulur kokën me flokët e qethura shkurt mbi një libër dhe ishte përqendruar aq shumë sa nuk e ngrinte kokën fare. Prita disa sekonda dhe u kollita për t'i tërhequr vëmendje. Ai ngriti kokën dhe më pyeti si e kisha punën. Pagjumësia, i thashë. Mirë - më tha dhe më dha dy hapa. Njërën pije këtu, tjetrën në kapanon. Pastaj u zhyt përsëri në faqet e librit. Unë, mosbesues, nuk lëviza vendit. Doktori u shkëput nga libri dhe më pyeti pse nuk

➔



## DEKLARATAT

### Belind Këlliçi

"Qytetarët duhet ta kenë shikimin nga opozita, si e vetmja alternative. Na takon ne, të rinjve dhe PD, që në aleancë me qytetarët dhe elitat e kombit, duke përfaqësuar denjësisht demokratët, të përndjekurit, pronarët, t'i rikthejmë shpresën këtij vendi", tha kreu i FRPD.

### Ftesat

Partia Demokratike feston ditën e hënë, më 11 dhjetor në Pallatin e Kongreseve 27-vjetorin e krijimit të saj. Mes shumë të ftuarve do të ketë edhe të majtë. Ftesat për të marrë pjesë në eventin e organizuar në orën 18:00 i janë adresuar edhe për përfaqësues nga PS-ja dhe LSI-ja.

### Astrit Patozi

"A ka më kuptim të diskutohet për vlerën e votës në këtë vend, kur ajo manipulohet, vidhet dhe deformohet kaq hapur e brutalisht edhe në universitete? Gjithsesi, gëzuar 8 dhjetorin! Se të paktën një fitore është arritur. Është shpallur zyrtarisht dhe me ligj si ditë pushimi", tha Patozi.

Meta: E papranueshme, shqiptarët kërkojnë Evropën jashtë vendit edhe pas 27 vitesh

# Basha, thirrje të rinjve: Ngrihuni, merrni fatet e vendit në dorë

## Rama, studentëve: Mos e lidhni të ardhmen me punë shteti

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, u bëri thirrje të rinjve të guxojnë, të ngrihen dhe të luftojnë për ta ndryshuar Shqipërinë. Nga aktiviteti i organizuar për 27-vjetorin e Lëvizjes Studentore në Qytetin Studenti tek shtatorja e Azem Hajdarit, z. Basha kujtoi 8 dhjetorin e 1990-ës dhe tha se ishte dita kur kuraja triumfoi mbi frikën. "27 vjet nga rënia e komunizmit, liritë e shqiptarëve janë të kufizuara, sepse ata nuk votojnë dot të lirë, sepse dinjiteti i tyre është i nëpërkëmbur dhe ne vazhdojmë të mbetemi një nga kombet më të izoluara. Është e paimagjinueshme që sot në Shqipëri të flitet për një bandë trafikantësh injorantë e mizorë, të flitet si të luftojmë për të pastruar Parlamentin nga vrasës e përdhunues dhe të diskutojmë si të pastrojmë ekonominë nga paratë e krimit", u shpreh z.Basha. Duke akuzuar qeverinë se ia ka shitur vendin një grushti oligarkësh, "ftoj rininë shqiptare të kthejmë sytë nga 8 dhjetori dhe të reflektojmë. Për shumë prej tyre, ëndrrat e 27 viteve më parë janë të njëjtat me ato të sotme. Nëse brezi i sotëm lufton si ai i mëparshëm, Shqipëria do të ecë përpara. Sepse Shqipëria ka nevojë sot më shumë se kurrë për atë forcë e kurajë të 27 viteve më parë. Kjo sfidë është sfida e rinisë. Unë e di që ju, rinia, do ta merrni në dorë këtë mision. Ju bëj thirrje, mos zgjidhni largimin, por përballjen", deklaroi z.Basha. Në 27-vjetorin e lëvizjes së studentëve të dhjetorit, Presidenti Ilir Meta deklaroi se është e patolerueshme për politikën që pas thuajse 3 dekadash, të rinjtë e talentuar dhe të aftë të këtij vendi ta gjejnë Evropën jashtë vendit të tyre. Meta foli gjatë një ceremonie të mbajtur në ambientet e Presidencës për nderim të Ditës së Rinisë dhe lëvizjes së dhjetorit. "Duhet të bëjmë gjitha përpjekjet tona për të ngjallur shpresat, sepse është e papranueshme që edhe sot, pas 27 vitesh, shumë të rinj të aftë e të talentuar ta kërkojnë Europën jashtë vendit të tyre. Një vend pa të rinj është si një familje pa fëmijë, ndaj kjo nuk është vetëm një ditë nderimi, por edhe një ditë apeli për të gjithë të rinjtë e sotëm që të mësohen dhe inkurajohen nga bashkëmoshatarët e tyre të atëhershëm", - tha Meta. Po dje, kryeministri Edi Rama gjatë një bashkëbisedimi me studentët deklaroi para tyre se nuk duhet të fiksohen pas punës së shtetit, teksa shtoi se ambicia e tyre duhet të jetë më tepër se kaq. Përgjigja e tij erdhi pas pyetjes së një studenti për mundësitë që u ofrohen. "Një tapet të kuq asnjë qeveri nuk ka për askënd. Askush nuk e ka një tapet të kuq për të siguruar parakalimin triumfal dhe hyrjen në derën më të lartë të shtetit për dikë që ka mbaruar shkëlqyeshëm. Ajo që dua të theksoj është se shumë shpesh, në Shqipëri dhe rajon shumica dërrmuese e vajzave dhe djemve, pavarësisht nivelit të arsimimit, e konsiderojnë të ardhmen e tyre si të lidhur me shtetin. Dhe punën në shtet si punën më dinjitoze, unë shpresoj të mos e keni këtë, shpresoj që ambicia juaj të jetë më shumë se kaq", deklaroi Rama.




Kreu i PD-së, Lulzim Basha, në aktivitetin e organizuar për 27-vjetorin e Lëvizjes Studentore në Qytetin Studenti

### Patrick Voller: Duam një opozitë të fortë

Sekretari për Marrëdhëniet me Jashtë në Partinë Popullore Europiane, Patrick Voller dha në Tiranë mesazhe të rëndësishme për luftën kundër të paprekshmëve të krimit dhe drogës, për drejtësinë pa ndërhyrje politike dhe për mbështetjen e PD dhe Lulzim Bashës. Duke folur në aktivitetin për 27-vjetorin e lëvizjes studentore, zoti Voller tha se, "sfidat për rininë e sotme, 27 vjet pas 8 dhjetorit, janë se 65% e të rinjve dua në largohen nga vendi". Por, Voller ftoi të rinjtë të qëndrojnë në Shqipëri dhe të ndryshojnë gjendjen. "Ne kemi nevojë në Shqipëri për një opozitë të fortë e të bashkuar në rrugën e përbashkët drejt Europës. Duhet të punojmë bashkërisht që korrupsioni dhe krimi i organizuar të luftohen me ndershmëri dhe ata që cilësohen si të paprekshëm, duhet të japin llogari dhe të gjithë të jenë të barabartë para ligjit. Këtu ka nevojë për shumë punë dhe falë PD-së, prej vitesh ka një orientim ndaj kësaj teme kaq të rëndësishme këtu", - tha sekretari për Marrëdhëniet me jashtë në PPE.

## Berisha, thirrje të rinjve: Ta përmbysim këtë qeveri

27 vite pas lëvizjes studentore të 8 dhjetorit, lideri i demokratëve, Sali Berisha, një ndër protagonistët e atyre ngjarjeve u është drejtuar me një mesazh të rinjve shqiptarë, të cilët i ftoi të ngrihen kundër narkoshtetit, që sipas tij është kthyer në kërcënim për shqiptarët. "Kjo datë ka një mesazh të madh guximi. Fitojnë ata që guxojnë, zgjidhja është vetëm guximi juaj. Ju keni 1001 arsye të ngiheni fuqishëm. Ju jeni dhjetëra herë më shumë se kjo sallë, por vetëm kjo sallë do të mjaftonte për ta hedhur në Lanë këtë qeveri", deklaroi z.Berisha.



Për kreun e demokratëve, 27 vjet nga rënia e sistemit komunist, liritë politike të shqiptarëve janë sërish të kufizuara. Ashtu si në 8 dhjetor të 1990, Basha tha se misioni për të ndryshuar vendin i takon sërish rinisë. "Sytë e shqiptarëve janë nga ju, mos zgjidhni largimin, zgjidhni përpjekjen, përballjen, guxoni, ngrihuni, luftoni ta ndryshojmë Shqipërinë", u shpreh z.Berisha. Në përkujtim të 8 dhjetorit, Ditës së Rinisë, drejtuesit më të lartë të Partisë Demokratike zhvilluan homazhe pranë shtatores së Azem Hajdarit në Qytetin Studenti.

←

ikja. Do më thuash të vërtetën - i thashë - do të më zërë vërtetë gjumi, apo m'i dhe hapat vetëm për efekt psikologjik? Ai u ngrit në këmbë dhe me një ton krejt të ndryshëm nga i pari, më tha: 'Po ti e shikon që është ora gati tre e mëngjesit dhe unë nuk fle dot për vete"? Përfitova nga fakti që u ngrit më këmbë dhe i hodha një sy librit, ishte Dostojevski. Nuk më kujtohet në ç'gjuhë, por me siguri në rusisht. Shqip jo e jo, sepse ishte i ndaluar dhe nuk ishte përkthyer fare. Berisha ishte lexues i rregullt dhe i vëmendshëm i gazetës "Drita". Jo rrallë të dielave në mëngjes pinim kafe tek Pesëmbëdhjetëkatëshi, siç i thoshim atëherë hotel "Tiranës" dhe kur shkoja unë, ai e kishte mbaruar gazetën dhe më bënte "analizën" e hollësishme. Ishte shumë kërkues, por kishte të drejtë në ato që kërkonte dhe që ne nuk mund t'i realizonim për arsye që dihen.

**Si u arrit tek themelimi i PD-së dhe cilat janë bisedat që iu kanë mbetur në mendje?**

Unë nuk kam qenë pjesë e grupit apo grupeve që u mor direkt me themelimin e PD-së, kështu që nuk mund të flas për to. Ajo që më ka mbetur në mend dhe s'do ta harroj për gjithë jetën ishte mitingu madhështor me rastin e deklarimit të shpalljes së PD-së në Qytetin Studenti. Nuk mund ta harroj entuziazmin, dalldinë, ekstazën dhe dehjen e asaj turme aq të madhe. Një dehje dhe trullosje të tillë do ta shikoja pas disa muajsh në sheshin "Skënderbej" ditën e rrëzimit të shtatores së diktatorit.

Ishte një gëzim i shumëpritur, i ligjshëm. Por mua më ngjante me gëzimin e trojanëve kur kujtuan se ikën grekët. E ndjeja që ishte shumë herët për t'u entuziazmuar aq shumë, e dija që zhgënjime po aq të mëdha do të pasonin. Duke zbritur nga kodra ku është Qyteti Studenti, si për të paralajmëruar zhgënjimin e parë, filloi një shi i furishëm. Atëherë më erdhën në mendje vargjet që i botova pak më vonë, profecia e të cilëve nuk do të doja kurrë të dilte e vërtetë: 'Pushuan thirrjet entuziaste, U ulën gishtat si një V ngritur në erë. Atëherë u kujtuam që këpucët na fusnin ujë dhe lata e druve duhej prerë...'.

**A besoni se brenda PD kishin depërtuar njerëz të Sigurimit të Shtetit?**

Do të ishte e çuditshme po të mos kishin depërtuar. Por, sado të duket e tmerrshme, nuk është kjo e rëndësishmja. E rëndësishme është a kishte PD frymën e këtyre njerëzve dhe a mbronte interesat e tyre. PD asnjëherë nuk ka pasur frymën e tyre, siç e kanë zakonisht ku më shumë e ku më pak partitë që e kanë origjinën nga partitë e dikurshme komuniste dhe që kudo, me përjashtim të Shqipërisë, tani janë shndërruar në fosile ose në forca të parëndësishme politike.

**Përse u përça PD ndër vite dhe përse u copëzua kaq shumë?**

Janë të shumta dhe të ndryshme arsyet. Do të shkonte shumë gjatë po të përmendnim edhe një pjesë fare të vogël të tyre. Por kryesorja sipas meje është se ajo qysh në fillim nuk u ndërtua mbi parime të tilla demokratike sa t'i siguronin një mbijetesë të gjatë. Natyrisht, parimet mbi të cilat u ngrit dhe u udhëhoq ishin demokratike, por nuk ishin në atë masë sa t'i siguronin një mbijetesë të tillë të gjatë, të cilën e pretendon pyetja juaj. Dhe shkaku i dytë, sipas meje, është qeverisja ose më saktë keqqeverisja. Sidomos katër vitet e dyta të mandatit qeverisës 2005-2013 kanë qenë fatale dhe kanë ndikuar shumë në shpërbërjen dhe uljen e besimit tek PD. Ministrat që qeverisën në emër të PD gjatë viteve 2009-2013 janë përgjegjës kryesorë për gjendjen në të cilën ndodhet PD sot.

**Si mund të ringrihet Partia Demokratike sot?**

Të rithemelohet. Jo të arnohet nga po të njëjtit 'rrobaqepës' që përgatitën 'shqepjen' e saj. Dhe më tej, as PD, asnjë parti tjetër nuk mund të ringrihet me mllef e me urrejtje, por me dashuri. "Në zemrën që digjet nuk hyhet me çizme, por me ledhatime", thotë një poet i madh.

"Rama e kreu i PD-së janë bashkë, një "8 Dhjetor" i dytë duhet për t'i shembur"

# Topalli: Basha ka uzurpuar karrigen, nuk pajtohem me të

## "Lëvizja e re në PD? Nuk e kam menduar"

*Ish-nënkryetarja e PD-së, Jozefina Topalli deklaroi mbrëmë në "Studio e Hapur" në "News24", se ka ardhur koha për një 8 Dhjetor të ri, që të rrëzojë këtë klasë politike. Sipas saj, lideri i PD-së, Lulzim Basha, për të cilin thotë se po e mban me forcë e dhunë PD-në është bërë bashkë me kryeministrin e vendit Edi Rama dhe kanë mes tyre jo thjesht interesa politike, por edhe financiare. Për t'i rrëzuar, Topalli thotë se duhet një 8 dhjetor*



Ish-nënkryetarja e PD-së Jozefina Topalli dje në emisionin "Studio e Hapur"

**Znj.Topalli, nga "8 Dhjetori" lindi PD që e drejtoi vendin për 13 vjet. A ka mbetur në PD ajo fryma e vitit '90. A ka sot lidhje PD me atë parti? Jo vetëm personazhet, por edhe filozofia.**

Partia Demokratike ka sjellë lirinë. Liria funksionon, në këto 20 vite kanë ndodhur ndryshime drakoniane. Jemi të lirë. Kemi thënë atë që mendojmë kemi ecur përpara në rrugën e integrimit, jemi pjesë e NATO-s. Unë nuk mendoj se sot përfaqëson ndonjë gjë nga ajo që ka qenë ëndrra e viteve të fillimit. Po të më pyesësh thellë-thellë nuk di në ia vlen, dhe a ka ndonjë gjë nga emri i PD. Kanë marrë siglën e PD, por aty mbaron çdo gjë. Kjo është ndjesia ime, qofsha e gabuar.

**Zemra e partisë është grupi parlamentar, në këndvështrimin e ëndrrës së "8 Dhjetorit" si e shihni atë?**

Nuk dua të përgjithësoj. Në shumë raste sillet midis mediokritetit dhe vulgaritetit. Kam bindjen e thellë se s'ka asnjë lidhje me atë të 8 dhjetorit 1990, sepse ka rrëzuar vlerat dhe parimet. Funksionon me një miks të asaj që është ambicia financiare dhe axhenda politike e lidershipit të këtij grupi, që nuk e quaj grupi i PD, sepse s'ka ardhur nga Partia Demokratike dhe as nga forumet, s'ka asgjë nga vlerat dhe parimet mbi të cilat është ngritur kjo forcë.

**Ju mungon ajo sallë, përplasjet, argumentet, keni kaluar aq kohë në atë sallë?**

Kam menduar se do më mungonte, janë më shumë se dy dekada e përfshirë emocionalisht, mendërisht e fizikisht 24 orë në 24 orë. Jo, kur e shoh sot nuk më mungon. Më bën të mendoj që ai teatër i shëmtuar i aktorëve që janë bashkë në interesat që ato ndajnë, s'e kam fjalën vetëm për interesa politike, është e shëmtuar. Nuk është ajo për të cilat lindi 8 dhjetori.

**Ju po thoni që Rama e Basha janë bashkë në interesa financiare, jo vetëm politike në marrëdhënie partnerësh?**

Ata janë bashkë në një marrëdhënie shumë opake.

**E lidhni me marrëveshjen e 18 majit?**

Është një marrëveshje e nëndheshme edhe para 18 majit, që u bë gjatë majit më vizive, por edhe më pas. Ke për ta parë edhe në muajt që vijnë.

**Si e shihni këtë?**

Është e dhimbshme kanë thyer besimin dhe ëndrrat e shqiptarëve. Harrojnë që shqiptarët kuptojnë. Është një klasë politike që kërkon një betejë të fortë. Kur unë bëja politikë e kam sulmuar për dy gjëra Edi Ramën. Secili që bëhet kryeministër, i kam thënë Edi Ramës, se një kryeministër që drejton një qeveri ku populli kërkon të ikë, i ikën mbi 200 mijë vetë dhe vendi është i mbuluar nga droga, një rekord shumë i zi. E kam akuzuar Edi Ramën në çdo seancë parlamentare. Nëse shqiptarët besojnë se ekziston një alternativë ata kanë shpresë. Nëse mendojnë që nuk ekziston kjo rrugë, zgjedhin të ikin.

**Ju po bëni njëlloj përgjegjës Bashën?**

Njëlloj jo, se do isha e pandershme por, në proporcion i takon po aq pjesa e fajit për largimin e të rinjve dhe familjeve shqiptare.

**Për çfarë arsyeje?**

Mund të dish dhe mund të mos dish të drejtosh vendin. Por nëse interesat financiare mbizotërojnë mbi dhembshurinë dhe dashurinë që duhet të kesh mbi vendin tënd, portat e së ardhmes janë të mbyllura. Ndaj them që kjo klasë politike ka nevojë për reformim të thellë. As të rinjtë që janë sot në politikë nuk përfaqësojnë me të vërtetë të rinjtë shqiptarë.

**Ju ia vini deri tani përgjegjësinë edhe opozitës sigurisht për këtë mungesë shprese, por ju kujtoj se ju e goditët Lulzim Bashën në fillim të fushatës, pastaj u tërhoqët, u publikuan lista, por pastaj zëri kundër në PD erdhi dhe u bë më i dobët. A mund të themi sot se s'ka zëra kundër në PD?**

E kundërta është, në fakt. Çdo ditë e më shumë bindem se kam bërë gjënë më të mirë që kam thënë të vërtetën time, atë që unë kam besuar. Koha që kalon, mua më jep të drejtë. Fakt është që gjatë fushatës sheshet ishin bosh, kur, në fakt, demokratët ishin mësuar të dyndeshin në shesh si asnjë forcë tjetër, pas fushatës sallat ishin bosh, sot ke një kryetar që ecën vetëm, që nuk takon asnjeri, që sillet nëpër zyra të një godine që është bosh, një oborr bosh e me kafe. Kjo s'ka qenë asnjëherë PD, për aq sa e njoh. Kemi kaluar periudha ulje-ngritje magnetizmi, ndryshime të jashtëzakonshme, ndjeheshim mirë kur arrinim disa objektiva.

**Tani çfarë po ndodh ku janë zërat kundër? Ka pasur edhe një përçarje mes vetë zërave kundër, nuk u bëtë asnjëherë bashkë?**

Janë të gjithë bashkë, janë shqiptarët të gjithë bashkë që janë tërhequr dhe po shohin, nuk i shkojnë më pas.

**Jeni dorëzuar?**

Jo, jo. Po ta shpjegoj. Askush prej atyre që kanë besuar te PD nuk dorëzohen. Fakti që po hesht nuk do të thotë se jam në qoshe dhe indiferente ndaj politikës, në fakt, është e kundërta. Ka qenë një periudhë dhe po e shihja se opozita do ta kapte për shkak të krizës që po kalon qeverisja aktuale, pas gjitha skandaleve asgjë nuk ndodhi. Të dy palët përpiqen të mbulojnë e shantazhojnë njëri-tjetrin, për një pazar të ri. S'ka nevojë të jesh shumë në politikë për ta lexuar këtë. Kam filluar ta lexoj me kohë. Duhet koha e caktuar për një "8 Dhjetor" të ri. Unë besoj se të rinjtë shqiptarë kanë për t'i dhënë vendit të tyre një "8 Dhjetor" të ri. Nuk e di formën, mënyrën, si do jetë mënyra dhe koha, por di që kjo klasë politike ka dështuar.

**Pra, nuk jeni pajtuar me idenë se Basha do rrijë për një kohë të gjatë në PD…**

Unë nuk pajtohem me një njeri që e merr karrigen me dhunë, e uzurpon atë dhe e përdor për interesa financiare të familjes dhe oligarkëve.

**Si mund të mbahet peng një parti me dhunë, forumet, institucionet?**

S'ka forume. Ke dëgjuar të mblidhen ndonjëherë? Unë nuk jam pajtuar kurrë, por Basha nuk do ta lëshojë kurrë atë karrige, vulën dhe siglën do ta mbajë peng derisa shqiptarët të vendosin që të bëjnë zgjidhje dhe të gjitha humbjet që do pasojnë ai do t'i quajë fitore. Ndaj them që ka ardhur koha për një "8 Dhjetor" të ri.

**DEKLARATA**

"Duhet koha e caktuar për një "8 Dhjetor" të ri. Unë besoj se të rinjtë shqiptarë kanë për t'i dhënë vendit të tyre një "8 Dhjetor" të ri. Nuk e di formën, mënyrën, si do jetë mënyra dhe koha, por di që kjo klasë politike ka dështuar",-tha znj.Topalli.

**Brenda PD po thoni?**

Brenda gjithë klasës politike se 20 e ca vite më parë, 8 Dhjetori ndryshoi rrënjësisht politikën shqiptare. Ashtu e kalbur siç është ka nevojë për një lëvizje endemike.

**Do viheshit në krye të kësaj lëvizjeje?**

Besoj se ka nevojë për një "8 Dhjetor" po aq të madh sa i pari. Nëse e para ishte diktaturë që kishte mbytur çdo qelizë të mendimit dhe lirisë, ky i dyti është diktaturë e korrupsionit dhe mjerimit, por s'ka dhunë më të egër dhe gjë më fyese se sa kontratat që bëjnë politikanët shqiptarë.

**Do viheshit në krye të këtij 8 Dhjetori, qoftë edhe parimisht?**

As parimisht, as taktikisht. Unë kam ndalur hapin, pasi dikush ka vendosur të mos jem në atë sallë. I falënderoj me gjithë zemër që s'jam sot në atë parlament. Më shumë se kurrë jam e bindur se duhet një reformë e madhe.

**A mendoni se do jeni sërish pjesë e atij parlamenti?**

Nuk e di, sinqerisht. Mundet po, mundet jo. A do vijë dita që do e shohim Jozefina Topallin si pjesë të një formacioni politik, përveç PD? Nuk e kam menduar. E di që ka një vakum të madh në politikë, një mos përfaqësim të thellë, a do vijë një forcë e re politike këtë nuk e di. Fakti është që edhe skena botërore dhe europiane ka zhvillime të jashtëzakonshme. Janë kohë që nuk e dimë çfarë ndryshimesh do sjellim.

**Çfarë do t'ju ulte me Lulëzim Bashën në një tryezë?**

Asgjë, kam qenë e ulur dhe kam ikur vetë. Është fyese ta kesh në krye të tryezës atë, fyen veten. Kohët do ta tregojnë më shumë unë sot s'kam dëshirë të flas për Lulzim Bashën, është konsum shpirtëror i madh.

## Ruçi-Pelosi: Shqipëria, aleat i rëndësishëm i SHBA në Ballkan

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë u takua dje, në Kongresin Amerikan, me kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve, z. Paul Ryan, me kryetaren e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve znj. Nancy Pelosi dhe me kryetarin e shumicës republikane në Dhomën e Përfaqësuesve z. Kevin Mc Carthy. Në bisedë me kryetaren e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve znj. Nancy Pelosi, u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet SHBA-ve dhe Shqipërisë. Lidhur me këtë, znj. Pelosi u shpreh se: "Shqipëria është një aleat i rëndësishëm i Shteteve të Bashkuara në Amerikës në Gadishullin e Ballkanit". Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, pasi e falënderoi znj. Pelosi për mikpritjen, theksoi rëndësinë e vijimit intensifikimit të marrëdhënieve shumë të mira ndërmjet dy vendeve. Z. Ruçi vlerësoi kontributin e dhënë nga kryetarja e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan duke u shprehur se: "Keni mirënjohjen tonë për mbështetjen dhe angazhimin tuaj personal ndaj Shqipërisë". Gjatë takimit, z. Ruçi e ftoi znj. Pelosi për të vizituar Shqipërinë. "Është dëshira ime dhe e parlamentit shqiptar që ju të vizitoni Shqipërinë",- nënvizoi ndër të tjera Kryetari i Kuvendit. Ftesa e z. Ruçi u pranua nga znj. Pelosi, e cila tha se do të jetë kënaqësi që të vizitojë Shqipërinë. Znj. Nancy Pelosi, gjithashtu, i tha z. Ruçi se në grupin e kongresmenëve demokratë keni një mik të mirë të shqiptarëve si z. Eliot Engel. Duke marrë fjalën në takim, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla u shpreh: "Ne i jemi shumë mirënjohës Partisë Demokratike Amerikane për vëmendjen ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve dhe duam të rrisim më tej bashkëpunimin".

## Meta takon Princin Albert. Monako, projekt me rëndësi në Sazan-Karaburun

Presidenti i Republikës, SH.T.Z Ilir Meta u takua dje, në Marsejë me Lartësinë e Tij, Princin Albert II të Monakos. Presidenti Meta theksoi në bisedë me Princin Albert se dy vendet tona kanë një orientim të përbashkët në politikën e jashtme, ndaj inkurajoi më tej zhvillimin e dialogut politik. Presidenti i Republikës vuri në dukje se është në interes të dy vendeve forcimi i bashkëpunimit veçanërisht në fushat ku Principata e Monakos luan rol të veçantë, si në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në atë të ruajtjes së mjedisit në pellgun e Mesdheut. Presidenti Meta vlerësoi përkushtimin e Princit Albert II dhe angazhimin e tij serioz në fushën e biodiversitetit dhe mbrojtjen e ambientit duke e ftuar për të vizituar Shqipërinë e në veçanti zonën e Sazan-Karaburunit, ku synohet realizimi i një projekti të rëndësishëm mjedisor. Lartësia e Tij, Princi Alberti II e pranoi me kënaqësi këtë ftesë dhe shprehu angazhimin e tij për një bashkëpunim më të ngushtë midis dy vendeve.

## Kryemadhi me Engel: Zbatimi i reformës në drejtësi me rëndësi jetike për qytetarët

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë aleati ynë më i madh strategjik dhe kanë një rol të pazëvendësueshëm në historinë, të sotmen dhe të ardhmen e Shqipërisë, deklaroi kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi gjatë vizitës në SHBA. Në një takim me kongresmenin e njohur dhe miku i madh i shqiptareve, Elliot Engel, i cili u fokusua në zhvillimet më të fundit politike në Shqipëri, Kryemadhi vlerësoi rolin dhe kontributin e tij të vazhdueshëm për Shqipërinë dhe shqiptarët, për zhvillimin dhe integrimin euro-atlantik, si dhe për forcimin e shtetit ligjor dhe demokracinë në vend. Duke folur për domosdoshmërinë e avancimit të zbatimit rigoroz të reformës në drejtësi, Kryemadhi tha se "Zbatimi i reformës në drejtësi ka rëndësi jetike për qytetarët shqiptarë dhe klasa politike ka përgjegjësi madhore për të mos humbur më kohë në këtë proces". Nga ana e tij, kongresmeni Engel vlerësoi miqësinë e kahershme mes dy vendeve dhe popujve tanë. Ai konfirmoi mbështetjen e SHBA-së në proceset e mëtejshme demokratizuese në Shqipëri, si dhe vlerësoi rolin e Shqipërisë në rajon si një faktor stabiliteti dhe paqeje.

Komisioneri për Menaxhimin e Krizave, Stylianides: Ky është solidariteti evropian në veprim

# Përmbytjet, BE ndihma për Shqipërinë. Serbia, 100 mijë euro, batanije e dyshekë

## Kryeministrja serbe, Ana Brnabi i ka dërguar një letër Ramës

Darina Tanushi

Bashkimi Evropian ka vendosur të ndihmojë Shqipërinë për të përballuar situatën e përmbytjeve. Pas kërkesës që iu dërgua pak ditë më parë nga autoritetet shqiptare, Komisioni për Ndihmën Humanitare dhe Menaxhimin e Krizave ka ofruar mbështetje me pompa uji, gjeneratorë dhe mjete të tjera përmes Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së. Bashkimi Evropian iu përgjigj menjëherë kërkesës për ndihmë, falë mbështetjes nga Austria, Franca, Sllovakia dhe Sllovenia. Shqipërisë iu ofrua mbështetje edhe nga sistemi satelitor Copernicus, i cili ofroi hartat dhe pamjet satelitore për autoritetet kombëtare të mbrojtjes civile. Një ekip evropian i mbrojtjes civile është zhvendosur në Shqipëri dhe do të asistojë këto dy ditë autoritetet shqiptare gjatë ofrimit të mbështetjes. Komisioneri për Ndihmën Humanitare dhe Menaxhimin e Krizave Christos Stylianides tha: "Solidarizohemi për të mbështetur popullin shqiptar në këtë kohë. Më lejoni të falënderoj për mbështetjen e madhe vendet anëtare të BE-së, të cilët siguruan ndihma dhe furnizime përmes Mekanizmit tonë të Mbrojtjes Civile Evropiane. Ky është Solidariteti Evropian në veprim." Ndërkohë edhe qeveria e Serbisë do të dërgojë 100 mijë euro ndihma për zonat e përmbytura në Shqipëri. Për shkak të situatës së vështirë, siç shkruajnë mediat serbe, qeveria e Serbisë do të dërgojë edhe ndihma në mallra, siç ka njoftuar zyra për bashkëpunim dhe media pranë qeverisë në Beograd.

Gjithashtu, kryeministrja serbe Ana Brnabi? i ka dërguar një letër homologut Rama, me të cilën i bënte me dije për ndihma në rreth 500 batanije, 250 dyshekë dhe mjete të tjera. Ajo shprehu shpresën se kontributi do të lehtësonte sado pak efektet e përmbytjeve. Në fakt, ndihma e Serbisë ndaj Shqipërisë ka qenë edhe në shkurt të vitit 2015, kur u dhanë sërish 100 mijë euro, shifër të cilën pak muaj më parë, në tetor të 2014 ja kishte akorduar qeveria e Shqipërisë, Serbisë, kur u përfshi nga përmbytjet së bashku me Bosnje-Hercegovinën. Në këtë kohë qeveria shqiptare akordoi edhe 50 mijë euro ndihmë për Luginën e Preshevës. Në të tilla raste, duket se shtetet solidarizohen me njëri-tjetrin, duke lënë pas mosmarrëveshjet politike. Por, në të njëjtën kohë, që prej 2014-ës duket qartazi se raportet Shqipëri-Serbi janë në një tjetër stad.



Nga përmbytjet e fundit

## Gjylameti: Aferat e kontenierëve, Berisha futi në xhep 100 mln euro

Deputetja e Partisë Socialiste, Blerina Gjylameti akuzoi dje, ish-kryeministrin Sali Berisha se përmes një firme për koncesionin e kontenierëve, futi në xhepat e tij mbi 100 milionë euro me një firmë të vetme. Në një deklaratë për media nga kryesia e Kuvendit, Gjylameti tha dje, se përmasat e kësaj afere kanë skandalizuar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Një ditë më parë, rrjeti prestigjioz "Bloomberg" publikoi prova të pakundërshtueshme se gjysma e 250 milionë dollarëve të kontratës së lidhur midis shtetit dhe kompanisë amerikane që fitoi tenderin, iu kalua në formë ryshfeti ish- kryeministrit Berisha dhe njerëzve të tij më të afërt. Investigimi ka zbardhur edhe skemën e kësaj afere. Rapiscan Systems, me bazë në Kaliforni, fitoi tenderin për këtë kontratë qindra-milionë dollarësh, por vetëm disa muaj më pas shiti 49% të aksioneve te një kompani shqiptare e padëgjuar deri më atëherë. Shitja e aksioneve u bë vetëm për 490 lekë. Pra, një gjysmë, që në letër vlen të paktën 125 milionë dollarë, iu kalua kompanisë së ish- kryeministrit Berisha për vlerën e një kafeje", tha Gjylameti. "E gjithë kjo aferë,- theksoi ajo,- ndodhi vetëm disa muaj përpara zgjedhjeve të 2013-s."

### Raporti i Bankës Botërore

## "Plakja në Ballkan, shqetësuese për rritjen e ekonomisë"

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ku bën pjesë edhe Shqipëria po plaket me ritme të shpejta, teksa popullsia parashikohet të vazhdojë të rënie. Banka Botërore në një analizë të fundit për rajonin raportoi se trendi i plakjes së popullsisë po krijohet nga normat e ulëta të fertilitetit të shoqërua me emigracion të lartë. Shkalla e fertilitetit rajonal ra nga 3.9 në 1.6 fëmijë për grua gjatë 1965-2015. Emigracioni parashikohet të vazhdojë të reduktojë popullsinë e rajonit, megjithëse jo aq shumë sa në të shkuarën. Bosnja dhe Hercegovina, e cila ka moshën mesatare më të lartë në mesin e gjashtë vendeve me 41.5 vjeç në vitin 2015 për të arritur në 53.9 në vitin 2065, e dyta më e lartë në botë. Nëse vendet e Ballkanit nuk marrin masa për të për frenuar përkeqësimin e situatës, Banka Botërore thotë se vendet do të përballen me ulje të produktivitetit, pasi plakja në rajon do të ulë pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe do të frenojë rritjen mesatare vjetore të të ardhurave për frymë me 0.4 pikë përqindje gjatë 50 viteve të ardhshme. Banka Botërore analizon se plakja popullatës do të çojnë në një dyfishim të varësisë së të moshuarve ndaj moshës së punës nga viti 2015 deri në vitin 2050. Në tri dekadat e ardhshme përfitimi nga dividendit demografik do të jetë zhdukur në Ballkan dhe të ardhurat për frymë do të përkeqësohen. Në fillim të vitit 2017, popullsia në Shqipëri ishte 8 mijë persona më pak se parashikimet e INSTAT-it për këtë vit, sipas të dhënave zyrtare. Rënia në raport me pritshmëritë ka qenë më fatale për grupmoshën 0-15 vjeç, ku tkurrja ka qenë me 10 mijë të rinj më pak sesa pritej. Shqiptarët mbi 60 vjeç këtë vit janë 93 mijë më shumë në numër se në vitin 2011, kur u bë Censusi i fundit. Kjo grupmoshë tani zë 18.8% të krejt totalit të popullsisë nga 15.4% që ishte në vitin 2011.




PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqesor privat **Ermir Godaj** zhvillon ankandin e pare per shitjen e pasurise se paluajtshme "Truall me sip.totale 206 m², nga te cilat 206 m² Ndertese, me Nr. Pasurie 554/3, Vol.5, Fq.183, Z.K.3070, e ndodhur ne Puke", e lene kolateral per garantimin e kredise, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit ProCredit Bank Sh.a., per shumen 1'822'310.51 (nje milion e teteqind e njezete e dy mije e treqind e dhjete pike pesedhjete e nje) Leke.
Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 1'354'656 (nje milion e treqind e pesedhjete e kater mije e gjashteqind e pesedhjete e gjashte) Leke.
Ankandi zhvillohet ne date 18.12.2017, ora 16.00 ne zyren e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

albpetrol

**Aplikim për të përfituar Statusin e Naftëtarit**

Njoftohen të gjithë punonjësit dhe ish-punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a se, bazuar në Ligjin Nr.8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazit" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425 datë 10.05.2017, se ka filluar shpërndarja e dokumenteve për Statusin e Naftëtarit. Personat e interesuar që të pajisen me dokumentet përkatëse duhet të paraqiten pranë njëres prej qendrave të punës ku kanë punuar dhe të fillojnë procedurën.

Shoqëria Albpetrol sh.a sqaron të gjithë personat e interesuar se disponon dokumentacion për periudhën që kanë punuar në shoqërinë Albpetrol sh.a nga viti 1994 e në vazhdim. Për periudhën përpara vitit 1994, dokumentet mund të merren pranë Sigurimeve Shoqërore ose arkivave të tjera.

Personat që duan të pajisen me vërtetim të posaçëm zyrtar për periudhën përkatëse duhet të plotësojnë formularin përkatës, i cili mund të shkarkohet në adresën www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/ ose mund të tërhiqet fizikisht pranë qendrave ku kanë punuar.

Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në qendrat ku keni punuar së bashku me një kopje të librezës të punës ose mund të dërgohet me postë në qendrën përkatëse.

Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia: Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos /Tiranë, Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Pallati Sky Tower
**T** +3553813662 **F** +35534704415 **w** www.albpetrol.al

## Prokuroria: Shmangu skanerin e kamionit në port

# Trafikimi i 2.5 tonëve drogë në Itali, lihet në burg nënkomisari i policisë së Fierit e 6 të tjerë



Droga e sekuestruar në Itali

**HETIMI**

Sipas prokurorisë, grupi kriminal është hetuar për më shumë se një vit, në të njëjtën mënyrë siç është hetuar edhe grupi i Habilajve, i cili trafikonte lëndë narkotike nga Vlora drejt Italisë me gomone.

**TIRANË** - Gjykata e Krimeve të Rënda caktoi dje masën e sigurisë "arrest me burg" për nënkomisarin e policisë së Fierit, Festim Lelaj dhe 6 të dyshuarit e tjerë për lidhje me një grup kriminal, që trafikoi në janar të këtij viti 2.5 tonë drogë nga Shqipëria në Ankona. Në bankën e të akuzuarve u ulën edhe dy policët Gëzim Dervishi e Agron Kapllani; doganieri Altin Katundi; agjenti doganor Mikail Hila si dhe Skënder Siceqa dhe Arbi Mustafa. Asnjëri prej të pandehurve nuk e pranoi akuzën, duke mohuar lidhjen me grupin kriminal. Ndërkohë, prokuroria tha se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, ata kanë favorizuar trafikimin me kamion të lëndës narkotike, që u bllokua në Ankona në janar të këtij viti. Përfaqësuesi i organit të akuzës tha se ka prova të forta që nënkomisari Lelaj ka rolin e organizatorit në trafik. Në kohën kur u bllokua sasia rekord e drogës në Itali, Lelaj ishte me detyrë specialist krimesh në Dibër, ndaj prokurorët po hetojnë nëse hashashi është kultivuar në këtë qark, për t'u trafikuar më pas jashtë vendit. Sipas prokurorisë, kamioni me drogë kaloi nga porti i Durrësit, ndërsa ka dyshime se nuk u është nënshtruar procedurave standarde të kontrollit, duke mos u futur në skaner. Për këtë arsye, të dyshuar për përfshirje në grupin kriminal janë doganieri Katundi dhe agjenti doganor, Hila. Po sipas prokurorisë, në kohën kur punonjësi i policisë, Festim Lelaj punonte në portin e Vlorës ka lejuar trafikimin e 350 kg kanabis po me kamion. Muaj më parë për llogari të të njëjtit hetim janë vënë në pranga, edhe disa të dyshuar të tjerë.

## Lezhjani u ndalua nga Italia gjatë deportimit, kërkohej për vepra kriminale

# Amerika dëbon shqiptarin Lul Lucaj, i dënuar me 14 vite burg për vrasje

## *41-vjeçari u arratis në SHBA në rrugë ilegale*




41-vjeçari Lul Lucaj



LUCAJ, LUL
WANTED BY THE JUDICIAL AUTHORI

IDENTITY PARTICULARS

| | |
|---|---|
| Present family name: | LUCAJ |
| Forename: | LUL |
| Sex: | Male |
| Date of birth: | 20/11/1976 |
| Place of birth: | LEZHE, AI |
| Language spoken: | Albanian, |
| Nationality: | Albania |

CHARGES Published as provided by requ

| | |
|---|---|
| Charges: | MURDER |

Një 41-vjeçar i dënuar në mungesë në vendin tonë për vrasje është dëbuar nga territori Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga zyra për emigracionin. Bëhet fjalë për Lul Lucajn, i cili u shoqërua nga oficerët e deportimit në aeroport, për t'u kthyer në vendin e tij të origjinës me një avion tregtar. Teksa pritej që të merrej nga autoritetet shqiptare pas mbërritjes në Tiranë, kur kaloi transit në Romë, 41-vjeçari u ndalua nga autoritetet italiane. Kjo, pasi këta të fundit deklaruan se shtetasi shqiptar Lucaj kërkohej gjithashtu në Itali për vepra kriminale. Një zyrtar i Zyrës së Emigracionit në Nju Jork, Thomas Decker, tha se Lucaj erdhi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një i dënuar për vrasje, në përpjekje për t'u shpëtuar krimeve që kishte kryer. "Ne do të vijojmë që të godasim kriminelë të huaj, mbi të gjitha ata që kërkojnë strehim në komunitet tona dhe do të sigurohemi që t'i dëbojmë drejt vendlindjes së tyre, në mënyrë që të përballen me drejtësinë atje", pohoi Thomas Decker. "Interpol Red Notice" raporton se në gusht të vitit 2000, Lucaj u përfshi në një konflikt me dy vëllezër në Romë, sherr i cili çoi në vdekjen e njërit prej tyre. Më vonë, Lucaj vrau edhe vëllain tjetër. Ai u arrestua në Shqipëri. Qeveria italiane dhe ajo shqiptare ranë dakord që Lucaj të gjykohej nga një gjykatë shqiptare. Në qershor të vitit 2009, ai u dënua në mungesë nga Gjykata e Lezhës për vrasje me 14 vite burg e gjysmë. Në mars të vitit 2015, agjentët e "Homeland Security" e arrestuan atë dhe e akuzuan për shkelje të rregullave të emigracionit, pasi kishte hyrë në Shtetet e Bashkuara në rrugë ilegale. Fillimisht Lul Lucaj fitoi lirinë duke paguar një garanci financiare, por një vit më vonë u konsiderua person i rrezikshëm për shoqërinë dhe në janar të vitit 2017 ra në pranga sërish. Vendimi për dëbimin e tij nga territori amerikan u mor në maj nga një gjykatë vendëse. Që prej 1 tetorit 2009, zyra e emigracionit në SHBA ka dëbuar mbi 1.700 shtetas të huaj, të fshehur atje për t'i shpëtuar drejtësisë për krime të rënda si vrasje, pengmarrje dhe përdhunime.




# Europol: Shqipëria, burimi kryesor i trafikimit të kanabisit në Europë

**TIRANË** - Kanabisi mbetet deri më tani droga e paligjshme më e përdorur në Europë, ndërsa Shqipëria vijon të jetë burimi kryesor i bimës së kanabisit. Një raport i sapopublikuar nga Organizata Europiane e Policisë, "Europol", pohon se tregu i drogës në vendet europiane prodhon 24 bilionë euro fitime për trafikantët dhe rrjetet e krimit të organizuar. Raporti flet se rreth 35 për qind e grupeve të krimit të organizuar aktive në Bashkimin Europian janë të përfshira në prodhim, trafikim ose shpërndarje të drogës. Raporti i Europolit vlerëson ndërkohë se rruga e Ballkanit mbetet rruga kryesore e hyrjes për pjesën më të madhe të heroinës në Bashkimin Europian, njofton VOA.

## SHKURT

### 48-vjeçari gjen granatë e letër kërcënuese në banesë

**CËRRIK** - Një familje nga fshati Liçaj i Njësisë Administrative Shalës në Cërrik është kërcënuar dy ditë më parë në banesë. Denoncimin për ngjarjen e ka bërë i zoti i shtëpisë, një 48-vjeçar me inicialet B.L.. Ai ka pohuar në polici se kur ka shkuar në banesën në pronësi të tij, ku nuk banonte njeri, ka gjetur mbi oxhak një granatë dore difensive të montuar me ndezës dhe pranë saj një letër kërcënuese. Menjëherë ka njoftuar policinë, e cila ka sekuestruar letrën dhe granatën në cilësinë e provës materiale. Ndërkaq, policia e Elbasanit po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve. Materialet i kaluan prokurorisë së Elbasanit për veprën penale "Kanosje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

### Sherri në lokal, klienti plagos me armë zjarri pronarin

**VLORË** - Policia e Vlorës ka shpallur në kërkim një 46-vjeçar, pasi akuzohet se ka plagosur me armë zjarri pronarin e një lokali. Sipas bluve, ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë në lagjen "Uji i Ftohtë". Pas sinjalizimit se një person i plagosur ka mbërritur në spitalin e qytetit bregdetar, policia ka shkuar në këtë institucion dhe nga verifikimi ka rezultuar se shtetasi D.C., 51 vjeç, është plagosur (në këmbë), me armë zjarri gjatë një konflikti të çastit për motive të dobëta në lokalin e tij në lagjen "Uji i Ftohtë" prej shtetasit E.V., 46 vjeç, (klient në lokal). Menjëherë është shpallur në kërkim agresori, ndërsa po punohet për kapjen e tij, si edhe për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

### Tritol dyqanit në Fushë-Krujë, policia në kërkim të autorëve

**FUSHË-KRUJË/** Një shpërthim me lëndë plasëse është regjistruar në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Fushë-Krujë. Mësohet se objektiv ka qenë muri i një dyqani, në pronësi të shtetasit me inicialet E.Xh., 36 vjeç. Burime nga policia lokale bënë me dije se fatmirësisht nga shpërthimi ka pasur vetëm dëme materiale. Sakaq, grupi hetimor po punon për përcaktimin e llojit të lëndës plasëse, identifikimin dhe kapjen e autorëve. Materialet i kaluan për hetime të mëtejshme prokurorisë së rrethit të Krujës.







Gjendja në ambientet e Urgjencës së QSUT

**REPORTAZH/** Çfarë ndodh në spital pas nënshkrimit të peticionit për dorëheqjen e 12 mjekëve

# Urgjenca e QSUT, mes dyndjes së pacientëve e mjekëve të palodhur

## *Radhë të gjata për vizita e mungesë shtretërish*

Voltiza Duro

Një sirenë rrënqethëse ambulance dëgjohet mbyturazi, ndërkohë që mjekët vrapojnë për të marrë në barelë të sëmurin. "Ju lutem shpëtojeni!", - thërret me lot ndër sy një grua e imët rreth të 40-ve. Një grumbull i madh njerëzish janë ulur në stolat përballë derës së "shpresës", ndërkohë që shumë prej tyre, me ushqime në duar kërkojnë me ngulm të futen brenda për të parë të dashurit e tyre. Roja thinjosh, me një vështrim të vëngërt, shtyn derën me shpejtësi e në mes turmës që pret, arrijmë të kalojmë brenda ambienteve të Urgjencës së QSUT-së. Që në hyrje ndeshesh me karriget e mbushura plot me të sëmurë që presin ndihmë, disa të tjerë po rënkojnë në shtrat e madje ka edhe nga ata që vërtiten të çoroditur nëpër korridoret moderne. E gjithë kjo pamje të sjell ndërmend kampet e luftës apo pritjet në radhët e gjata në pikat kufitare. Por jo... Kjo është beteja e fundit, beteja për jetën në ambientet e Urgjencës Qendrore. Një grua e moshuar, me flokë të bardhë e një fytyrë të zbehtë është ulur në stolin ngjitur, ndërkohë që infermierja me shpejtësi afrohet me një aparat tensioni në duar. Ndërkohë, një mjek thërret: "Zotëria ka nevojë për një gjak komplet", por pacienti vazhdon të vërtitet dhe pyet: "Ku të ulem?!". Mjeku ngre supet e përgjigjet: "Ah... këtu është problemi". Pikërisht, mungesa e shtretërve kundrejt këtij fluksi e ka shndërruar Urgjencën në një "arenë", ku të sëmurët rendin kush e kush të zërë krevatin më parë.



> **SITUATA**
>
> Pamja brenda ambienteve të Urgjencës së QSUT-së të sjell ndërmend kampet e luftës apo pritjet në radhët e gjata në pikat kufitare. Por jo... Kjo është beteja e fundit, beteja për jetën në ambientet e Urgjencës Qendrore.

**URGJENCA**

Prej kohësh, Urgjenca Qendrore e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" gjendet në kaos, për shkak të numrit të ulët të mjekëve përballë fluksit të të sëmurëve, që e shohin këtë godinë si shpresën e tyre të vetme. Dyndja e pacientëve nga i gjithë vendi drejt dyerve të QSUT-së e ka bërë të papërballueshme punën për "bluzat e bardha", të cilët përpiqen me sa fuqi kanë për t'u ardhur në ndihmë, por kushtet ku punojnë nuk janë të mjaftueshme. Të 13-të mjekët "heronj" vrapojnë për të shpëtuar jetë, e duhet të luftojnë edhe me trysninë që mbart në vetvete profesioni i tyre sa fisnik, edhe i vështirë. Kjo mbingarkesë ku pacientët rrinë të shtruar mbi 48 orë në këtë pavion, është edhe arsyeja kryesore, që i detyroi 12 prej tyre, të lajmërojnë 30 ditë para tërheqjen nga pozicioni i punës nëpërmjet firmosjes së një dorëheqjeje kolektive. Organika e QSUT-së parashikon që në shërbim të Urgjencës të jenë 16 mjekë, por mesa duket në krye të detyrës janë vetëm 13. E janë pikërisht këto kushte pune, që i kanë detyruar edhe 7 specializantë të QSUT-së që të marrin rrugën për Gjermani, me shpresë për një jetë më të mirë, ku profesionit të tyre i jepet vlera e dinjitetit që meriton.

> **MBINGARKESA**
>
> Kjo mbingarkesë ku pacientët rrinë të shtruar mbi 48 orë në këtë pavion, është edhe arsyeja kryesore, që i detyroi 12 prej tyre, të lajmërojnë 30 ditë para tërheqjen nga pozicioni i punës nëpërmjet firmosjes së një dorëheqjeje kolektive.

**PACIENTËT**

Duke rënkuar, pacientët përpiqen të arrijnë sa më parë mjekun, shpresën e tyre të vetme të shpëtimit. Ata të gjithë kërkojnë ndihmë, por mundësitë për ta marrë në kohë janë të pakta. Mungesa e besimit në spitalet rajonale dhe mungesa e medikamenteve në shumë prej tyre i ka bërë që të turren drejt QSUT-së. "Kam 3 orë që po pres në radhë, më erdhi një infermiere më mati tensionin, por s'ka krevate. Ka që janë edhe më keq se unë e do i liroj radhën se kanë emergjencë", - tregon një e moshuar me fytyrë të zbehtë e shtrirë në karrige. Ka plot raste kur të sëmurëve u duhet të qëndrojnë edhe mbi 2 ditë në Urgjencë, pasi edhe në pavionet e tjera, vendet janë të zëna. Me shpresën që "garës" për krevatet e lira t'i jepet fund, pacientët e Urgjencës përballojnë këtë situatë tejet të vështirë, që mund të rezultojë fatale për jetët e tyre.

**FAMILJARËT**

Përballë dyerve të Urgjencës, familjarët kërkojnë me padurim të dinë mbi fatin e të afërmve të tyre. Me fytyra të zbehura nga lodhja e me trastat me ushqime, janë në pritje të hapjes së derës me xham çka për ta është ora e vizitave me të sëmurët. Afrohemi pranë një plaku rreth të 60-ve, i cili me duart që po i dridhen nga ankthi po dredh një cigare. "Po pres të di për vajzën, e kam aty brenda e kam frikë. Ndoshta e shpëtojnë. Por mjekët janë sjellë shumë mirë me ne, e aty ka shumë njerëz, nuk e di si ia bëjnë, ju e shikoni vetë të sëmurët rrinë nëpër karrige, s'ka krevate mesa duket", - tregon ai me sy të përlotur. Ndërkaq, një tjetër familjare thotë se kanë ardhur nga Kamza për të sjellë motrën e sëmurë në urgjencën e QSUT-së. "Nuk kemi dhe aq besim te spitalet e tjera, e dimë që këtu mund të kurohen më mirë. Vetëm një natë e mbajtëm në spital në Kazmës e me vrap e sollëm këtu, nuk mund të rrinte më gjatë në një vend që dhe serumet i blinim ne. Nuk kishte ilaçe e s'kemi lekë t'i mbulojmë shpenzimet vetë, është e papërballueshme. Këtu po gjen derman", - shprehet motra e pacientes së shtruar në Urgjencë.

"Më shumë praktika mësimore për studentët, tarifat të paguhen me 2 këste"

# Sabri Laçi, dekani i ri i Histori-Filologjisë: Procesi u manipulua

## "KZF urdhëroi largimin e vëzhguesve"

Voltiza Duro

Me miratim të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit, prof. Dr. Sabri Laçi është shpallur dekani i ri i Fakultetit të Histori-Filologjisë, pasi fitoi me 50.14% të votave kundrejt rivales Aljula Jubani. Ky proces zgjedhor është shoqëruar me polemika e kontestime të shumta nga të dy kandidatët, që akuzojnë njëri-tjetrin për manipulim e presion ndaj stafit akademik dhe studentëve. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", dekani i ri i FHF, Sabri Laçi tregon se ka pasur shumë shkelje të rregullores e se vëzhguesit janë lënë jashtë procesit qëllimisht për të manipuluar votimin. Madje, ai ka raportuar edhe një rast, ku fleta e votimit të një studenti i është dhënë një pedagogu për të deformuar rezultatin përfundimtar.


Prof. Dr. Sabri Laçi

**Me vendim të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit jeni shpallur dekani i ri i Histori-Filologjisë. Me sa vota u shpallët fitues?**

Rezultati që miratoi KZF më shpalli fitues me 50.14% të votave. Duket një diferencë e ngushtë, por për mua është shumë i rëndësishëm, pasi jam fitues falë votave të studentëve, por edhe të stafit akademik normalisht, por diferencën e kanë bërë studentët, që më besuan 308 vota më shumë sesa rivalja. Kjo për mua është një mrekulli, sepse pavarësisht trysnisë e presioneve që iu bënë me qëllim manipulimin, studentët rezistuan e ndenjën në radhë me përkushtim për të votuar profesorin që dëshironin.

**Si shkoi procesi i votimit?**

Mund të them se procesi i votimit për dekanin e Fakultetit të Histori-Filologjisë ishte një proces i vështirë e me probleme të panevojshme. U bënë përpjekje për manipulim, për trysni ndaj stafit dhe vetë studentëve. Gjatë këtij procesi pati shkelje të herëpashershme të rregullores.

**Në cilat pika u konstatuan këto shkelje të rregullores?**

Janë konstatuar disa shkelje të rregullores si moslejimi për të votuar i një anëtari të trupës akademike, në kundërshtim flagrant me nenin 11, pika 1/a. Vlen të theksoj një tjetër shkelje të rëndë, që ishte mosdhënia në mënyrë të qëllimshme e fletës së saktë të votimit njërit prej zgjedhësve, me synim deformimin e rezultatit përfundimtar të votimeve. Dhe u insistua fort që kjo fletë votimi të konsiderohej e pavlefshme.

**Prej kujt janë kryer këto shkelje?**

> **SHKELJET NGA KZF**
>
> "Shkeljet janë bërë kryesisht nga KZF dhe në mënyrë të veçantë nga kryetarja e këtij komisioni, Rozana Rushiti. Gjithashtu, komisioni nxori jashtë vëzhguesit dhe kandidatin nga salla ku administrohej procesi zgjedhor. Këto janë çudi që ndodhin këtu", tha Laçi.

Shkeljet janë bërë kryesisht nga KZF dhe në mënyrë të veçantë nga kryetarja e këtij komisioni, Rozana Rushiti, e cila në procesverbalin e "Mbylljes së Votimit" nuk ka argumentuar mospërputhjen mes numrit të fletëve të përdorura nga votuesit dhe shumës së mbetur të fletëve të shpërndara dhe të dëmtuara. Gjithashtu, komisioni nxori jashtë vëzhguesit dhe kandidatin nga salla ku administrohej procesi zgjedhor. Këto janë çudi që ndodhin këtu.

**Cilat janë disa nga problemet që keni konstatuar në këtë fakultet?**

Ka pasur mungesë transparence, efikasiteti, shpejtësie dhe ne këto do përpiqemi t'i ndryshojmë. Sot, studentët tanë edhe për mungesë të informimit e mbështetjes, nuk kanë gjetur hapësirat që meritojnë. Edhe në pjesën e praktikave mësimore ka shumë për të përmirësuar, pasi teoria pa praktikë mbetet e vdekur.

**Si mendoni ta përmirësoni procesin e praktikës mësimore, pasi shumë studentë ankohen për mungesën e saj?**

Pjesës së praktikës mësimore do i kushtohet një vëmendje e veçantë nga ana jonë. Ne do të përpiqemi të negociojmë fort me subjekte ku mund të realizohen praktikat për studentët tanë. Jam i sigurt që edhe partnerët tanë të ardhshëm do të jenë të kënaqur nga shërbimet që do iu ofrojnë studentët që do shkojnë për të mësuar e për të parë punën nga afër.

**A do të përmirësohen kushtet e studimit?**

Studentët tanë do të kenë kushte më të mira studimi dhe informimi, madje pretendojmë të krijojmë një strukturë të veçantë, ku studentët të informohen sistematikisht dhe të mos humbasin kohë për çfarëdolloj informacioni që atyre iu intereson. Jemi të gatshëm të investojmë për promovimin e vlerave të çdo studenti, pedagogu e institucioni. Potencialin e kemi të jashtëzakonshëm e duhet ta prezantojmë më mirë.

**A do u ofrohet studentëve lehtësim në tarifat e studimit?**

Ne nuk kemi bërë rritje të tarifave për të mos i rënduar shumë buxhetet e familjeve të tyre. Por do të luftojmë fort të mundësojmë pagesën e tarifës në dy këste, që është një lehtësim për secilin prej studentëve në të gjitha nivelet.

**Cilat janë disa nga ndryshimet e tjera që do të bëni tashmë që jeni dekani i Fakultetit të Histori-Filologjisë?**

Së pari, do ndërtojmë një marrëdhënie tjetër me studentët dhe me stafin, do t'u dedikohemi me të gjitha energjitë studentëve tanë, që meritojnë shumë më shumë, do jemi krah tyre në të gjithë procesin e edukimit në këtë fakultet. Do luftojmë që të realizojmë hapjen e shkollës doktorale, një ngërç që e ka universiteti prej 4 vitesh. Gjithashtu, do të fillojmë punën për përmirësimin e kurrikulave dhe modernizimin e tyre dhe përshtatjen e tyre në raport me kërkesat e tregut të punës. Më tej do të përpiqemi fort të forcojmë fondin për kërkim shkencor për stafin e studentët.

## KANDIDATJA ALJULA JUBANI:
### Presion ndaj studentëve e pedagogëve, 0.14% e diferencës nuk përbën votë

Rivalja për postin e dekanit në FHF, Aljula Jubani, e pyetur nga "Gazeta Shqiptare" shprehet se fituesi shpallet me një votë më shumë dhe nuk e konsideron 0.14% e diferencës si një votë. Ajo më tej shton se ka pasur një presion ndaj pedagogëve e studentëve, çka ka ndikuar në votën e tyre. "Komisioni Zgjedhor i Fakultetit nuk shpall fitues, por shpall rezultate. Sipas rregullores, fituesi shpallet me një votë më shumë, por 0.14% nuk përbën një votë. Procesin e numërimit unë nuk kam mundur ta ndjek gjatë gjithë kohës, por janë vëzhguesit e mi atje të akredituar nga KIZ, të cilët mbledhin të gjitha informacionet e m'i sjellin aty ku ka parregullsi. Këto parregullsi kanë filluar që në fushatën zgjedhore e janë pasuar edhe në ditën e votimit. Ka pasur një imponim ndaj studentëve dhe presion nga pedagogët. Këto shkelje unë i kam përcjellë në Komisionin Zgjedhor Institucional dhe të presim që gjërat do të sqarohen. Unë mendoj që duhet të respektojmë procesin, të përfundojë dhe pastaj të mund të themi se si janë të gjitha detajet", - tha Jubani.


Aljula Jubani

## Pedagogu: Ne kapëm shkelje e raportuam situatën

# Mark Marku: Tentuan qëllimisht të manipulonin votimin në favor të Jubanit

Ndërkaq prof. asoc. dr. Mark Marku, pedagog në departamentin e "Gazetarisë dhe Komunikimit" në këtë fakultet tregon për "Gazeta Shqiptare" se gjatë procesit të votimit, është bërë një tentativë për manipulim në favor të Aljula Jubanit. Marku thekson se fleta e votimit të një studenti i është dhënë një pedagogu, me qëllim që të dilte një votë mangët për Sabri Laçin. "Fleta e votimit të një studenti i ishte dhënë një pedagogu. Ky ishte një gabim i komisionit, jo një gabim njerëzor, ashtu siç nënshkruan në procesverbal. Ishte i qëllimshëm, për të nxjerrë një votë pedagogu mangët në favor të Sabri Laçit. Nuk ka mundësi të ndodhë një ngatërresë e tillë, pasi studentët votonin një kat më poshtë, ndërsa pedagogët lart. E gjithë kjo ishte bërë me vetëdije të plotë. Ishte një moment që ne e kapëm dhe e raportuam. Ky manipulim po bëhej në favor të Aljula Jubanit, pasi një tek votë e një pedagogu ka shumë peshë në rezultatin përfundimtar", - tha pedagogu. Gjithashtu, ai bën me dije se pas raportimit, komisioni nënshkroi fillimisht një procesverbal ku vota ndaj Sabri Laçit u konsiderua e vlefshme. "Ndërkaq pak orë më vonë, ky procesverbal u hodh poshtë dhe u nënshkrua një tjetër nga po i njëjti komision, që e nxirrte të pavlefshëm. Preteksti i kryetares së KZF, Rozana Rushiti, në lidhje me këtë ishte se procesverbalin e parë e nënshkroi në një gjendje të rënduar emocionale", - theksoi Marku për "GSH".


Prof. asoc. dr.Mark Marku

HISTORIA E GODINES

# MINISTRIA E SHPALL MONUMENT

## Rrëfimi i pronarit: Ballot vjeneze në shtëpinë e Abatit

Fatmira Nikolli

*Tefë Curani: Gjyshi im ia bleu Abatit Prenk Doçi, jemi gati ta japim për muze*

Shtëpia e Abatit Prenk Doçi në Shkodër është shpallur monument i mbrojtur nga shteti prej Ministrisë së Kulturës. Vendimi në fjalë merr rëndësi, në një kohë që një plan i ri ubanistik mund të kanoste ekzistencën e saj të mëtejshme. Ka qenë ministrja Mirela Kumbaro, që e ka njoftuar përmes një postimi në profilin e saj në rrjetin social "Facebook". "Në Shkodër i thonë 'Shtëpia e Abatit' ose selia e shoqërisë 'Bashkimi', falë së cilës kemi alfabetin e shqipes. Fjalori i 'Bashkimit', sikundër u quajt në motet më pas, sipas alfabetit latin u miratua në Kongresin e Manastirit (1908). Ministria e Kulturës vë në mbrojtje shtëpinë e Abat Doçit, jo vetëm si një vend i rëndësishëm historik, por edhe si një objekt arkitektonik interesant. Më tej çdo bashkëpunim është i rëndësishëm për ta restauruar atë", shkroi dje Kumbaro. Në këtë proces, ministrja ka pasur përkrah (dhe falënderon) Dom Artur Jakun dhe Dom Nikë Ukgjinin, dy priftërinj të Dioqezës së Shkodrës, që në një farë mënyre e kanë nxitur Kumbaron, duke këmbëngulur për vlerat historike e arkitektonike të godinës. E vendosur në anë të Katedrales së Shën Shtjefnit në Shkodër, "Gazeta Shqiptare", në muajin shtator mundi të fotografojë (me fotografen 'Lu Photography') ambientet e brendshme të saj, duke nxjerrë në pah njëherit, shkëlqimin e kahershëm e rrënimin e sotëm, (http://www.gsh.al/2017/07/27/fotot-brenda-shtepise-se-abatit-dhe-alfabetit-rrenimi-si-modus-vivendi/).

Historia e kësaj godine bëhet e mjegullt në fundin e 800-ës e fillimin e 900-ës. Një shkallare që të nxjerr në kat të dytë ka në anë mure të mykura, mbajtëse prej druri pothuaj të kalbur, ndërsa dyert e dritaret, 100 vite më pas, i ruajnë ende gdhendjet në drurin që është ngrënë sa nga kalbja, aq edhe nga insektet. Gjithçka ruhet e dhëmbëzuar, nga harqet te vetratat, nga tullat e bardha që dikur qenë të padukshme brenda murit, te kolonat mbajtëse, ku u shkrep fotoja e elitës kulturore të Shkodrës nga Marubi; diku ruhen ende gjurmët e altarit të kapelës së vogël që gjendej në shtëpinë e Abatit, hijembeturat yje të pikturuara në një mur në të kaltër; çdo gjë në ngrehinën që shuhet të flet për një histori që po humb. Vetëm tjegullat, vetëm ato ende mbahen, për të mos futur brenda zemërimin e qiellit.

### NGA ABATI TE (S)TEFË CURANI

Si shtëpi e Abatit të Mirditës, ajo u bë edhe selia e shoqërisë së themeluar prej tij në janar 1899, në Shkodër, e mandej veç emrit të tij te "Bashkimi", dhanë ndihmesën e vet të çmuar edhe emra si At Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Dodë Koleci, Dom Ndoc Nikaj, Anton Xanoni, Imzot Jak Serreqi, Imzot Lazër Mjeda, Atë Ambroz Marlaskaj, Nikollë Sheldija. Në mos për vlerën që pati si shtëpi e Abatit në Shkodër, godina, duhet çmuar e ruajtur për të qenit selia e 'Bashkimit'. 100 vite nga vdekja e Abatit e 109 vite nga Kongresi i Manastirit, selia e 'Bashkimit' dergjet, strukur në qendër të Shkodrës, pa rënë në sy - por së paku, u vu në mbrojtje, duke ndaluar shembjen e saj. "Gazeta Shqiptare" ka mundur të gjejë dhe të kontaktojë pronarin aktual të shtëpisë, Tefë Curani. Tefa për të cilin flasim është nipi i (S)Tefë Curanit (të vjetrit), një prej atyre që organizuan Kongresin e Triestes.

"Gjyshi im e ka njoh Prenkë Doçin", më thotë nga Italia ku ndodhet, Tefa (i riu). "Kanë qenë miq për një kohë të gjatë. Kishte hyrë e dalë disa herë në shtëpinë e Abatit. Takoheshin bashkë me Gjon Marka Gjonin, princin e Mirditës, të cilin e ndihmonte Prenk Doçi". E pyetën Tefën (të riun) se si shtëpia e Abatit u bë shtëpia e (S)Tefë Curanit (të vjetrit).

"Kur Abati e ndërtoi atë, ishte shtëpia më moderne në Shkodër. Brenda kishte një arredim perëndimor dhe ishte në stil barok. Ka qenë krejt ndryshe nga shtëpitë e kohës. Por të gjitha këto duhet të kenë qenë shumë të kushtueshme. Abati qe penduar disi, sepse kishte bërë shumë shpenzime për të dhe duheshin akoma më shumë për ta mbajtur atë shtëpi. Atëkohë gjyshi im donte shtëpi, kështu që Abati, i cili pa se nuk mundej ta mbante, ia shiti gjyshit tim, (S)Tefë Curanit (të vjetrit)", thotë Tefë Curani (i riu).

Shtëpitë e Shkodrës së kohës kishin kat përdhes dhe një kat lart, kurse kjo shtëpi nën çati kishte një 'belvdere', një sallon të madh nga i cili shihje qytetin kujton Curani. Shihje prej aty, minaret e xhamive dhe kompanjelet e kishave.

Tefë Curani i vjetri ishte një prej burrave më fisnikë të Shkodrës së kohës, njëherësh ndër më të pasurit. Zotëronte 7 gjuhë të huaja, ndaj kishte punuar në Ministrinë e Jashtme austro-hungareze me baronin Ludwig von Thalloczy. Martohet me Marie Stejner, në Vjenë më 1917. Kur erdh në Shqipëri, zotëronte një shoqëri vaporësh me emrin "Buna". Një prej vaporëve mbante emrin "Skëndërbeg". Atëkohë këto mjete transporti bënin linja të shpeshta transporti për udhëtarët. Tefa ishte kryeinspektor i një shoqërie lundruese triestine dhe lundrimin me linjat e tij të vaporëve e pat nisur me "Lloyd". Në qeverinë e Iljaz pashë Vrionit qe thirrur të bëhej ministër Financash (1920-1921), ndërkohë që Curani ishte mik me Fan Nolin, aksioner në fabrikën e duhanit "Stamless" si edhe aksioner në bankën italo-shqiptare të po atyre viteve. E pyes Curanin se ku gjendej kapela- kishëza e vogël brenda shtëpisë së Abatit Prenk Doçi. Më thotë që ishte në kat të dytë djathtas. Kur shtëpinë e kishte (S)Tefë Curani, në pjesën rrethuese të saj jetonin rojet me familjen dhe shërbimi. Në katin përdhes të saj ishte kantina dhe lavanteria, ndërsa para saj në oborr, një bllok i guri i madh shërbente që të ndihmonte burrat të hipnin në kalë. Po aty, për të bërë këtë bllok të dukej më bukur ka qenë kaherit një skulpturë.



*Në foto:*
**Tefë Curani** *(i riu)* **me bashkëshorten**



*Në foto:*
**Stefë Curani në mes, me Konicën majtas e Nolin djathtas**



*Në foto:*
**Salloni i shtëpisë së Abatit e Curanve**



*Në foto:*
**Shtëpia e Abatit dhe e Curanve sot**



*Në foto:*
**Vizatim i IMK-së për shpalljen Monument Kulture të shtëpisë së Abatit e Curanve sot**

### BALLOT VJENEZE TË KONSULLIT

"Kur familja ime ka banuar aty, gjyshi ka qenë konsull nderi i Austrinë (deri më 1939). Shtëpia vizitohej rregullisht nga diplomatët e huaj, pasi shërbente edhe si një lloj 'konsullate". Atëkohë, Stefë Curani organizonte edhe ballo vjeneze dhe në shtëpi nuk mungonin as fisnikë austro-hungarezë, miq të Tefës a vëllait të tij, që qe shkolluar në gjimnazin e mbretit të Austro-Hungarisë.

### SHTËPIA, NJË MUZE?

A do ta jepnin shtëpinë për muze? Tefa pohon. "Do e kishim dhënë për muzeum në një marrëveshje me shtetin shqiptar. Kemi pasur shumë kërkesa nga ndërtuesit që duan ta marrin e të ndërtojnë aty. Në komunizëm, gjyshi kishte vdekur dhe gjyshen e kanë nxjerrë nga shtëpia, duke ia dhënë godinën për përdorim sekretarit të parë të partisë pas çlirimit. Pastaj, komunalja ka futur aty 18 familje të banojnë, ngaqë ishte e madhe.

Në atë shtëpi u arrestua Stefë Curani i vjetri dhe djali i tij, babai i rrëfimtarit tonë. Kur shtëpia iu mor familjes, çdo gjë u sekuestrua me inventar, bashkë me orenditë e zonës së shërbimit, ku priteshin pajtonët. Po aty ruhej një karrige e Abatit, që sot, karrigia ruhet nga familja Curani në Itali. Karrigia ka qenë një lloj froni, që mbante Abati prej detyrës që kishte.

Curanët kishin koleksion armësh e shpatash, që prej aty u morën dhe u çuan në Gjirokastër nga shteti.

Poltronat e kësaj shtëpie - që kishte dy sallone, një për personalitetet që priste konsulli e një për miqtë - kanë qenë të kohës së Lugjit të XVI. Muret, ishin të veshura me letër, damask e të pikturuara.

Opinioni i Ditës

# Të zhduken presioni dhe pesha e pushtetit politik

Nga Natasha Mulaj

*(Vijon nga faqja e parë)*



... drejtësinë, ashtu edhe për impaktin që do të këtë ai në çdo qelizë të shoqërisë. Realisht pritshmëritë janë shumë të larta, dhe ne duhet të jemi, as më shumë dhe as me pak, por në lartësinë e tyre.

Që ta vendosin procesin në binare funksionale, unë jam katërcipërisht e bindur, dhe dua të nënvizoj më shumë forcë se në duhet ta fillojmë nga vetja, duke pastruar radhët tona. Mua me kumbon gjithnjë në vesh sentenca e reformatorit të njohur amerikan të shekullit të 19, Henri Uard Biçer, i cili pikërisht për këtë çështje është shprehur qartë:" Sikur të mblidhen bashkë në një të vetme të gjitha togat e zeza, te të gjithë gjykatësve të mirë që kanë jetuar mbi këtë tokë, nuk do të mund të mbulonin padrejtësinë dhe turpin e shkaktuar nga një gjyqtar i vetëm i korruptuar".

Kjo sentence është më aktuale se kurrë në vendin tonë, ndaj jam e bindur se ajo rrezonon fort tek të gjithë ne që kemi marrë përsipër këtë detyrë, që nuk është vetëm detyrë, por edhe mision. Unë ndihem vërtetë mjaft optimiste kur shoh sesa shume juristë të reja dhe të rinj, të mirë shkolluar dhe të ndershëm, kanë aplikuar për t'u bërë pjesë e strukturave tona. Ne duhet të jemi shpresëplotë se jemi në rrugën e duhur.

Domosdoshmëri për ne është fillimisht dhe mbi të gjitha qartësia dhe kthjelltësia e ligjit, çka ndikon direkt në dhënien e drejtësisë, duke eliminuar hapësirat për keqinterpretime dhe për ekuivoke. Së dyti, do të veçoja njohjen në perfeksion të tij nga të gjithë ne; dhe së fundi do të theksoja një tjetër moment, gjithashtu, tejet i rëndësishëm. Ne nuk duhet të kemi frikë. Presioni dhe pesha e pushtetit politik dhe i pushtetit të parasë duhet të zhduken përfundimisht. Ne duhet të vendosim drejtësinë në radhët tona, që t'u japim drejtësinë e ndershme të gjithë shqiptarëve.

Vetëm kur këto hapa të zbatohen në praktikë me shembuj konkretë, vetëm atëherë do të fillojmë të fitojmë respektin e dëmtuar rendë të qytetarëve tanë te drejtësia, si një pushtet krejtësisht i pavarur dhe i pandikuar prej askujt dhe asgjëje. Nuk mund ta theksoj mjaftueshëm, sesa jetike është për ne, të kalojmë në vepra; në vendime të drejta e të ndershme, të mbështetura tërësisht në prova të pakundërshtueshme, dhe që më pas ato të perceptohen të tilla nga opinioni publik.

Dua ta mbyll këtë fjalë me një sentencë, thënë nga ish-Presidenti Amerikan Teodor Ruzvelt, sipas të cilit: " Askush nuk është mbi ligjin dhe askush nën ligjin; dhe madje askujt nuk i merret leje kur i kërkohet ta zbatojë ligjin. Respektimi i ligjit merret si e drejtë dhe aspak si një nder".

***Autorja, Kryetare e Kolegjit të Apelimit***



BLUE TOOTH

Thashetheme MADE IN ALBANIA

Nr. 588

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 9 Dhjetor 2017


# NEVINA SHTYLLA

## "Bëhuni gati! Ja çfarë ju rezervon nata finale e festivalit"



# SOT FINALJA

## "Kënga Magjike", fitorja mes Fifit dhe Elhaida Danit












*• Edicioni i 19-të i festivalit të këngës, prapaskenat dhe kënga më e klikuar. Trofeu mbetet pezull, Anxhela Peristeri vjen "e çmendur" këtë finale*

## Këtë nuk e prisnim nga Klaudia, ja si vendosi t'i "thyejë" rregullat



• DANIEL DHE FOTINI NUK KANË MARRË ENDE ÇMIMIN E MADH? JA CILI ËSHTË SHKAKU I "SHTYRJES" SË DASMËS • AKTORI I "PORTOKALLI" PËRFUNDON NË GJYKATË? JA Ç'KA NDODHUR • ANGELA "NDEZ" INSTAGRAMIN: CILI POZICION JU PËLQEN MË TEPËR? • "TË NDARË" DHE FLASIN MË KODE? JA CILI ËSHTË "MESAZHI" I RADHËS QË ENI KOÇI I JEP GENCIT



# Daniel dhe Fotini nuk kanë marrë ende çmimin e madh? Ja cili është shkaku i "shtyrjes" së dasmës

S'kanë pak muaj që kanë dalë nga shtëpia e "Big Brother", çifti fitues, Danjeli dhe Fotinia tashmë i janë përkushtuar jetës së tyre të re, dhe kanë nisur punët respektive. Por nuk kanë harruar planet e dasmës, veçse i kanë shtyrë dhe kjo vetëm për një detaj të "vogël". Ditën e sotme ata i kanë kthyer përgjigje faktit të shtyrjes së dasmës së shumëpritur. Të ftuar në një emision të pasdites, çifti fitues i "Big Brother" ka rrëfyer jetën e re pak muaj pas fitores së show-t. Por nuk i shpëtuan dot pyetjes së të gjithëve: Pse u anulua dasma? "Ne po mendonim ta bëni gjatë verës", – tha Danjeli duke specifikuar se nuk kanë ndonjë arsye të veçantë, por kanë menduar se ajo është koha më e mirë. Ndërsa Fotinia shton se më 27 maj, ata bëjnë një vit të martuar zyrtarisht dhe ajo kohë do të jetë ideale për të bërë një dasmë të madhe: "Për verë do ishte më mirë, menduam, sepse tani na mungojnë edhe disa njerëz nga familja", – tha Fotinia. Ndryshe nga sa kanë thënë në rrjetet sociale, çifti e ka anashkaluar faktin se ende nuk kanë marrë paratë e çmimit fitues të "Big Brother" 9. Kushedi se pse ngurruan ta pranonin publikisht!







# Aktori i "Portokalli" përfundon në gjykatë? Ja ç'ka ndodhur

Një lajm i çuditshëm ka qarkulluar këto ditë lidhur me humoristin e "Portokalli"-së, Salsano Rrapi. Nuk na kishte vajtur në mendje, duke parë tipin e tij sportiv, se Salsano Rrapin do ta shihnim ndonjëherë nëpër dyert e gjykatave. Megjithatë, fansat dhe ndjekësit e moderatorit duhet të qetësohen, sepse ai është paraqitur aty jo për veten, por për të mbështetur një të afërmin e tij, i cili ishte arrestuar për drejtim mjeti në gjendje të dehur. Por edhe pse i gjendur në rrethana dhe ambient serioz, Salsano nuk i ka lënë batutat e humorit. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe me praninë e një humoristi të tillë.



# Angela "ndez" Instagramin: Cili pozicion ju pëlqen më tepër?

Ajo është një ndër femrat më "hot" të momentit dhe nuk rresht pa na mahnitur me fotot e ndryshme që poston në rrjetet e saj sociale. Po flasim pikërisht për Angela Martinin, e cila ndan me fansat e saj momente të veçanta duke ndezur herë pas here rrjetin. Këtë herë ajo ka publikuar tri nga pozat e saj të preferuara të të bërit foto dhe pyet ndjekësit e saj se cila është e preferuara e tyre. Modelja nuk nguron të provokojë duke treguar të pasmet e saj. Dhe, siç mund të paramendohej, fotoja e tretë ndër më provokueset ka qenë dhe e preferuara e fansave të saj. Angela tashmë, larg botës së modës për shkak se i është përkushtuar totalisht bashkëjetesës me miliarderin rumun, bën modelen herë pas here në profilet e saj në rrjetet sociale, dhe duket një seksbombë e vërtetë.





# Këtë nuk e prisnim nga Klaudia, ja si vendosi t'i "thyejë" rregullat

Ajo ka qenë shpesh në qendër të mediave rozë që pas bujës që bëri ndarja nga koreografi i njohur, Albi Nako. Klaudia padyshim që konsiderohet si një nga balerinat shqiptare më të mira dhe më në formë sa i përket linjave fizike. Sa herë që ajo shfaqet dhe gjithçka që ajo bën, arrin të tërheqë vëmendje dhe reflektorët e dritave fokusohen mbi të. Por këtë herë duket se Klaudia Pepa i ka "shkelur" deri diku rregullat e një balerine. Në një foto postuar së fundmi ajo duket se ka thyer disi regjimin dietik të saj prej balerine. Në foton e postuar në Instagram Klaudia është duke konsumuar një tost në përmasat "big". Ta këtë konsumuar vallë të gjithë racionin? Prapë me ushtrimet dhe fizikun që ka mbetet në topformë!








## "Të ndarë" dhe flasin më kode? Ja cili është "mesazhi" i radhës që Eni Koçi i jep Gencit

Edhe pse nuk e pranuan asnjëherë se kishin një lidhje bashkë, nuk kemi se si të aludojmë edhe për "ndarjen" e tyre. Eni Koçi dhe Genc Prelvukaj pretendohej të ishin çifti më i ri në showbiz, por ata këtë periudhë mendohet se nuk janë më bashkë. Kjo ka bërë që të shtohet edhe më shumë vëmendja në postimet e secilit, të cilat deri tani kanë treguar se "ish-çifti" është duke i dërguar mesazhe të koduara njëri-tjetrit. Edhe pse ende ndarja e tyre nuk është konfirmuar, Eni ka publikuar këtë foto, me fustanin ekstravagant në pjesën e gjoksit, poshtë së cilës shkruan: "Sjellja jote mund të më lëndojë, por e imja mund të të vrasë'. Një tjetër mesazh për Gencin ky?
Të jetë ky vallë kodi i radhës i komunikimit të këngëtares me Gencin?



## Zhduket nga Shqipëria dhe Zvicra, ja cilën "strofull të ngrohtë" zgjedh moderatorja e njohur

Ndërkohë që ne të gjithë po përgatitemi për një "dimër të egër", bukuroshja e njohur Floriana Garo është duke shijuar disa ditë pushime së bashku me partnerin e saj në një nga parajsat e Tokës, në Punta Cana. Moderatorja e njohur është në pritje të një vajze që me siguri do të jetë po aq e bukur sa e ëma. Pasi u zhvendos nga Shqipëria në Zvicër, Floriana vazhdoi edhe atje me të njëjtin intensitet punën së bashku me partnerin e saj. Por mesa duket ka ardhur momenti për disa pushime për mamin e ardhshëm, dhe pse jo? Floriana ka publikuar një foto në mes të palmave, e veshur me një fustan të shkurtër që tregon se moderatorja nuk ka shtuar shumë peshë nga shtatzënia, por përkundrazi ka marrë dhe një nur të bukur. Edhe pse fotoja është nga larg, dallohet paksa barku i rrumbullakosur i ish-misit. Pavarësisht shtatzënisë, Floriana duket në një formë fantastike.










### Edicioni i 19-të i festivalit të këngës, prapaskenat dhe kënga më e klikuar

# Sot finalja e "Këngës Magjike", fitorja mes Fifit dhe Elhaida Danit

*Trofeu mbetet pezull, Anxhela Peristeri vjen "e çmendur" këtë finale*

**Pamela Aliaj**

Ditën e sotme është nata e tretë dhe finale e festivalit më të ndjekur të "Kënga Magjike" ku priten shumë surpriza dhe të papritura në skenën e "Pallatit të Kongreseve". Por ajo që ne të gjithë mezi e presim është fituesi i edicionit të 19-të të këtij festivali. Ndër vite kanë qenë të ndryshëm, por mund të themi se disa artistë kanë fituar edhe 2 apo 3 herë radhazi. Ndër ta përmendim këtu divën e këngës Aurela Gaçe, e cila e ka fituar 3 herë çmimin e madh, apo edhe një tjetër zë brilant, siç është ai i Irma Libohovës, e cila ka qenë dy herë fituese e "Kënga Magjike" në fillim me duetin e bërë me motrën e saj, Eranda Libohova në vitin 2000, "Një mijë ëndrra", dhe pas katër vitesh me këngën e saj, "Prap tek ti do vij". Vitet kalojnë dhe tashmë kemi mbërritur në edicionin e 19 të këtij festivali ku shohim se të shumta janë këngët baladë, të cilat janë prezantuar këtë vit në skenë dy netët e para. Mesa duket, gjasat janë se kënga fituese mund të jetë baladë për të disatin vit radhazi, duke parë që përmbajnë tepër emocion dhe janë shumë prekëse.

Flasim pak edhe për jurinë që do të jetë ajo që do të gjykojë e do të japë mendimin e saj në skenë lidhur me performancat e ndryshme të paraqitura nga artistë të rinj edhe të vjetër. Ata janë po të njëjtët që kanë gjykuar kategorinë "New artist" të vitit të kaluar: Uliks Krajka, Sardi Shehu, Venera Lumani, Juliana Pasha dhe Olsi Curri. Përveçse kritikave dhe vlerësimeve që ata kanë dhënë nuk mund të lëmë pa përmendur edhe prapaskenat e këtij spektakli që nuk kanë qenë të pakta. Ndër to mund të veçojmë postimin që bëri natën e parë të këngës, një nga pjesëtaret e jurisë, këngëtarja Venera Lumani, e cila u duk sikur "i nxori bojën" festivalit. Ajo kishte publikuar në faqen e saj në Instagram një pjesë të skenarit të parapërgatitur që ajo mbante në dorë. "Çdo mendim i dhënë nga juria ishte i përgatitur, madje edhe e qeshura epike e Sardit duket se është menduar në çdo detaj. Në publikimin që ka bërë Venera në "Instagram" mes rreshtave lexohet çdo fjalë që ajo dhe Juliana thanë gjatë spektaklit. "S'kam ça me thënë. Ju duhet ta bëni publikun për vete. Hytë sikur do dilni"- shkruhet në skenarin që Venera mban në dorë.

Ndërkohë që natën e parë gjysmëfinale një tjetër incident ka ndodhur me moderatorët. Siç ishte thënë edhe më parë bashkëprezantues me Ardit Gjebrean ishin humoristët Bes Kallaku, Erion Isaj, si dhe dy bukuroshet e KlanTv, moderatorja e "Jo vetëm Modë", Nevina Shtylla dhe moderatorja e "Kush vjen për drekë", Arjola Shehu. I pari, që hapi mbrëmjen ishte sigurisht Ardit Gjebrea e më pas në skenë dolën edhe Bes Kallaku me Erion Isajn, të cilët nuk mund të mos sillnin të qeshura në sallë me batutat e tyre. Pas tyre, në skenë erdhën edhe vajzat, Arjola Shehu dhe Nevina Shtylla. Konkurrentët performuan një nga një në skenën e madhe të Pallatit të Kongreseve. Por ajo që nuk u pa, por u dëgjua pak pasi të fikeshin kamerat ishte fakti se pasi prezantuesit thanë natën e mirë, mikrofonat vazhdonin të ishin hapur dhe nga prapaskena u dëgjua të thuhej : "si l*sh ku**ve." Kushedi se për kë e kanë pasur këtë fjalor prezantuesit.

Gjithsesi t'i rikthehemi finalistëve të mbrëmjes së sotme. Ata janë plot 18 dhe vijnë në skenë me zhanre të ndryshme muzikore, por nuk lëmë pa nënvizuar se balada kryeson ndër to duke bërë kështu që mundësitë më të mëdha që edhe këtë vit, ashtu sikurse vitin e kaluar, dhe disa vite me radhë, e ka fituar zhanri i baladës festivalin. Po të shohim renditjen dhe numrin e klikimeve që kanë në youtube, edhe këtë vit, si çdo vit tjetër, mund të japim edhe ne një parashikim të vogël të fituesit të mundshëm të edicionit të 19-të të "Kënga Magjike", sigurisht në bazë



të klikimeve dhe të shikueshmërisë që kanë në online. Më poshtë rendisim finalistët dhe klikimet që kanë në youtube:

**E MËRKURË, 6 DHJETOR**
**Lind Islami** – Problemi- 78,875 shikime dhe 1 mijë pëlqime
**Mishela Rrapo** – E doja s'e doja- 41,044 shikime dhe 567 pëlqime
**Alar Band** – Leni ojnat- 198,432 shikime dhe 2 mijë pëlqime
**Rovena Stefa –** Veç një jetë- 228,084 shikime dhe 1 mijë pëlqime
**Xhesika Polo** – Jetën ma fal- 30,958 shikime dhe 290 pëlqime
**Elson Braha** – 23- 23,878 shikime dhe 419 pëlqime
**Çiljeta Xhilaga** – Hajmali- 1,030,214 shikime dhe 7 mijë pëlqime
**Kelly** – Kur ti buzëqesh- 128,770 shikime dhe 873 pëlqime
**Gjergj Leka** – Ndryshojmë- 25,165 shikime dhe 288 pëlqime
**Mentor Haziri** – Plagë në zemër- 41 240 shikime dhe 340 pëlqime
**Fifi** – Zhurmë- 3,090,154 shikime dhe 20 mijë pëlqime
**Stine** – Ma more zemrën- 1,799,491shikime dhe 8 mijë pëlqime
**Anxhela Peristeri** – E çmendur- 427,951 shikime dhe 3 mijë pëlqime

**TË RINJTË**
**All in Band** – Kundër rrymës- 27 603 shikime dhe 432 pëlqime
**Reinaldo Gaçi** – Mos harro- 13 507 shikime dhe 268 pëlqime
**Arieta Palushaj** – Simbiozë- 5 116 shikime dhe 104 pëlqime
**Armenda Gashi** – I huaj- 5 169 shikime dhe 130 pëlqime
**Toli** – Nuk kam frikë - 15 992 shikime dhe 284 pëlqime
**Serxho HD** – Pafundësi - 6 806 shikime dhe 143 pëlqime
**Majlinda Cikaqi** – Kam mall- 15 297 shikime dhe 185 pëlqime
**Genti Deda ft Dj Rob** – Dashuria - 51 185 shikime dhe 2 mijë pëlqime
**Andrea De Pascalis** – Goçe di Spirito - 9, 965 shikime dhe 237 pëlqime

**E ENJTE, 7 DHJETOR**
**Blerina Braka** – Mirupafshim dashuri - 715 910 shikime dhe 5 mijë pëlqime
**Franc Koruni** – Jemi njëlloj- 8 ,793 shikime dhe 77 pëlqime
**David** – Vetëm ne të dy - 45 298 shikime dhe 510 pëlqime
**Laura Nexha** – Je dashuri- 1,030,246 shikime dhe 5 mijë pëlqime
**Aurela Thellimi** – E diel - 148,531 shikime dhe 1 mijë pëlqime
**Valon Shehu** – Ti mos më shaj - 267,824 shikime dhe 2 mijë pëlqime
**Egzona Ademi** – E ndiej - 24,124 shikime dhe 345 pëlqime
**Fjolla Morina ft. Blasta** – Shake - 417 000 shikime dhe 2 mijë pëlqime
**Klejti Mahmutaj** – Më mbaj - 76, 614 shikime dhe 1 mijë pëlqime
**Kastro Zizo & Rea Nuhu** – Pa faj - 297,206 shikime dhe 4 mijë pëlqime
**Evi Reçi** – Dorëzohu - 45,886 shikime dhe 592 pëlqime
**Nrg Band** – Gocat me martini - 38,614 shikime dhe 434 pëlqime
**Samanta** – Humbur- 821,685 shikime dhe 7 mijë pëlqime
**Elhaida Dani** – E ngrirë- 569,102 shikime dhe 10 mijë pëlqime

**TË RINJTË**
**Algert Sala** – Je penduar- 8 140 shikime dhe 233 pëlqime
**Egys Shahu** – Fale zemrën- 230,579 shikime dhe 3 mijë pëlqime
**Albulena Jashari** – Njerëzit- 11, 279 shikime dhe 75 pëlqime
**Silvana Rusi** – Ai- 37,462 shikime dhe 376 pëlqime
**Albina Kelmendi** – Si n'fillim - 200,441 shikime dhe 2 mijë pëlqime
**John Shahu** – Medicine- 42,713 shikime dhe 1 mijë pëlqime
**Gerard Merdani** – Fjalët më mungojnë- 23,842 shikime dhe 358 pëlqime
**Xhon Jesku** – Je ne mua- 22,365 shikime dhe 512 pëlqime

Siç e shohim nga klikimet në vend të parë radhitet Filloreta Raçi me këngën "Zhurmë" me 20 mijë pëlqime dhe pas saj vjen Elhaida Dani me 10 mijë pëlqime me këngën "E ngrirë" dhe Stine në vend të tretë me këngën "Ma more zemrën" me 8 mijë pëlqime. Ndërkohë që për shikueshmërinë në vend të parë radhitet sërish Fifi me 3 milion shikime, në vend të dytë Stine me 1.7 milionë shikime ndërkohë që në vend të tretë është Laura Nezha me këngën "Je dashuri" së bashku me Çiljetën me këngën "Hajmali" me 1 milion shikime. Pra, mund të themi se sipas kësaj matjeje Filloreta Raçi, në bazë të klikimeve dhe pëlqyeshmërisë së njerëzve radhitet në vend të parë me baladën e saj tepër prekëse, "Zhurmë". Por, nga ana tjetër, një mundësi e mirë mund të jetë edhe Anxhela Peristeri. Këngëtarja që e gjen veten shpesh në festivale, kësaj radhe është paraqitur krejt ndryshe në edicionin e 19-të të "Kënga Magjike". Ndryshe nga kënga e vitit të shkuar me të cilën u radhit e dyta në festival, këtë herë e shohim jashtë kornizave që e kemi parë. Një super këngë, një popbaladë e realizuar nga studio Threedots përkatësisht nga Kledi Bahiti. Gjithsesi emocionet e kësaj mbrëmjeje ende presin të vijnë së bashku me vendimin përfundimtar të fituesit, të cilin e kanë në dorë vetë ata, konkurrentët. Suksese të gjithëve!







## Flet moderatorja: E vërteta e postimit të shumëpërfolur të Venera Limanit

# NEVINA SHTYLLA:

## Ju rrëfej prapaskenat e "Kënga Magjike" 2017

*"Bëhuni gati! Ja çfarë ju rezervon nata finale e festivalit"*

Pamela Aliaj

Ditën e sotme është finalja e "Kënga Magjike", edicioni i 19-të. Të shumta janë surprizat që na presin dhe prapaskenat që pëshpëriten lart e poshtë për atë që do të jetë fituesi i këtij edicioni. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", ka qenë pikërisht një nga moderatoret bukuroshe të këtij edicioni, Nevina Shtylla, njëkohësisht moderatore në KlanTv të "Jo vetëm modë". Ajo na ka rrëfyer marrëdhënien e saj me moderatorët e tjerë, prapaskenat e përfolura këto ditë të jurisë si dhe nuk ka harruar të përmendë edhe të japë mendimin e saj për këngën që mund të fitojë këtë edicion.

**Është hera e dytë që merrni pjesë te "Kënga Magjike". Si ndiheni të jeni sërish pjesë e një formati të tillë?**

Padyshim e lumtur për këtë pjesëmarrje. Është hera ime e dytë dhe duke u bazuar tek eksperienca e mëparshme, më duhet ta pranoj se e paragjykova pak. Por ndihem shumë e kënaqur për këtë mundësi të dytë, sepse këtë herë po e shijoj në maksimum çdo minutë. Si prezantues, jemi të gjithë në harmoni dhe ka një frymë vërtetë pozitive mes nesh.

**Si ndodhi përzgjedhja nga Arditi për të qenë prezantuese e "Këngës Magjike"?**

Besoj se ishte diçka e natyrshme. Një ide që mund t'i këtë ardhur me lajmin se do t'i bashkoheshim familjes së TV Klan. Nuk na e ka zbuluar ende së çfarë e nxiti saktësisht, por cilado qoftë arsyeja, i jam mirënjohëse. Çdo eksperiencë krah Ardit Gjebreas është e vyer.



**Këtë vit janë prezantuar shumë balada të bukura dhe prekëse. Ju nga gjithë këngët kë do të preferonit më tepër?**

Këtë vit ka një konkurrencë të fortë mes artisteve big dhe new. Dua të jem asnjëanëse pasi edhe posti i prezantueses ma jep këtë kufizim. E vetmja gjë që nuk mund të mos e them është se këtë vit ka artistë të rinj të shkëlqyer.

**Ka pasur ndonjë prapaskenë të papritur (zënkë) mes këngëtareve apo edhe mes prezantuesve?**

Jo, as që bëhet fjalë. Mes prezantueseve e thashë dhe me parë, nuk e prisja, por përputhemi shumë mirë me njeritjetrin. Sa i takon këngëtarëve, as në backstage nuk kam vënë re tension mes ndonjërit.

**Si i keni marrëdhëniet me Arjolën? Keni pasur bashkëpunime të tjera më parë?**

Sikurse e kemi pranuar disa herë dhe në intervista të tjera, marrëdhënia jonë është shumë e mirë. Është hera e parë që prezantojmë bashkë, por e kemi parë njëratjetrën të rritemi në tv, ndonjëherë në të njëjtën rrugë, ndonjëherë jo, por kjo s'na ka penguar aspak në marrëdhënien shoqërore që kemi.

**"Insta Girl-sat" janë një gjetje shumë interesante këtë vit dhe shumë argëtuese. Si është të prezantosh me Besin dhe Erionin? Kush të bën më tepër për të qeshur?**

Janë dy djem fantastikë. Dhe e them këtë me plotë gojën. I kam njohur nga ekrani, por janë edhe më të këndshëm kur i njeh personalisht, ma besoni. Shpresoj të kemi të tjera bashkëpunime edhe në të ardhmen pse jo?! Janë shumë të talentuar dhe në vijim jam e besimit se do të shfaqin të gjithë potencialin e tyre.

**Natën e parë Venera Lumani kishte postuar në faqen e saj në "Instastory" se juria ishte "udhëzuar" se si të sillej, deri tek e qeshura e dj Sardit. Si qëndron e vërteta?**

Nuk jam në dijeni të një postimi të tillë. Sidoqoftë di me siguri se juria ka qenë dhe është e lirë të bëj ç'të dojë në gjykimet që japin dhe askush nuk i kufizon apo edhe udhëzon. Sa i takon batutave mes "Insta Magic-girls" dhe jurisë, mund të them se ka qenë një nga momentet kulmore të mbrëmjes dhe të gjithë kanë qeshur me lot. Gjë që nuk mund të shtiret apo jo?!

**Cila këngë mendon se do të fitojë?**

Nuk di të them nëse është një këngë e vetme që meriton të fitojë, sepse realisht këtë vit ka pasur një prurje të jashtëzakonshme këngësh të bukura nga baladat e deri tek ato më ritmiket. Do të mbetet për t'u parë.

**Çfarë surprizash na rezervon nata finale?**

Nëse do t'i zbuloja nuk do të ishin më surprizë. Por do të ketë të papritura, bëhuni gati!





Ndërtuan pa leje, 240 personat që marrin tapitë për oborret

Ornela Manjani

# ALUIZNI, 216 pronarët përfitojnë kompensimin për truallin

## Vendimi, në të gjithë vendin 456 përfitues, lista

ALUIZNI publikon listën me 240 personat që kanë ndërtuar pa leje dhe marrin tapitë për parcelën ndërtimore dhe 216 pronarët që u është prekur tona nga ndërtimet pa leje dhe marrin kompensimin për truallin. Përfituesit janë në të gjithë vendin dhe "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë, ku përveç gjeneraliteteve të përfituesve, është edhe sipërfaqja takuese që legalizohet dhe shuma e përfitimit për pronarët që kompensohen.

**PROCEDURAT**

Personat që kanë ndërtuar pa leje përfitojnë tapi për një sipërfaqe që është e barabartë me trefishin e sipërfaqes së ndërtimit, por jo më shumë se 500 m2. Ndërsa pronarët kompensohen me vlerën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave në hartën e vlerës. Vlera e kompensimit varion sipas zonave. Sipas ligjit në fuqi, kur parcela e ndërtimit të legalizuar shtrihet mbi pasuri të paluajtshme në pronësi private të subjekteve joposeduese të ndërtimit, nëpërmjet të njëjtit akt administrativ miratohet masa dhe vlera e kompensimit financiar për sipërfaqet takuese, pronë private, që preken nga ndërtimi. "Vendimi i Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe miratimin e masës e vlerës së kompensimit për sipërfaqet, pronë private, që preken nga ndërtimet e legalizuara është i vlefshëm për regjistrimin përfundimtar të parcelës ndërtimore në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Sipas ligjit në fuqi, janë një sërë rregullash për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe miratimit të masës së vlerës së kompensimit", -thuhet në aktin normativ, që rregullon kompensimin e pronës së prekur nga ndërtimet pa leje. Nëse poseduesi është bashkëpronar në pasurinë ku ndodhet ndërtimi i legalizuar për rregullimin e pronësisë në parcelën ndërtimore zbatohen këto rregulla: a) Kur pjesët takuese ideale të bashkëpronësisë janë të papërcaktuara, ato prezumohen të barabarta (në përpjesëtim me numrin e të gjithë bashkëpronarëve). b) Pjesa takuese ideale e poseduesit llogaritet në sipërfaqen e parcelës ndërtimore. Nëse pas kësaj nuk plotësohet sipërfaqja e parcelës ndërtimore, për sipërfaqen e mbetur të saj kryhet kalimi i pronësisë në favor të poseduesit, si dhe kompensimi i bashkëpronarëve të tjerë, sipas pjesëve të tyre ideale. c) Mosmarrëveshjet për ndarjen e parcelës dhe për masat e pjesëve takuese zgjidhen nga gjykata. Nëse një nga bashkëposeduesit e ndërtimit të legalizuar është pronar i vetëm i pasurisë ku ndodhet parcela, krijohet bashkëpronësia mbi parcelën ndërtimore, duke u transferuar poseduesve të tjerë pjesët takuese të parcelës. Ndërkohë sipas këtij vendimi, për situata të mbivendosjes së titujve nuk pengon procedurat. Mbivendosja në parcelën ndërtimore shuhet me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, që miraton kalimin e së drejtës së pronësisë dhe vlerën e kompensimit financiar. Në këto raste, kompensimi financiar miratohet pa përcaktuar subjektin përfitues të tij, duke pasqyruar faktin e mbivendosjes së titujve në seksionin e veçantë të vendimit të Këshillit të Ministrave. Për zbatimin e kësaj pike, Agjencia e Trajtimit të Pronës detyrohet të caktojë, në një llogari bankare të posaçme, shumën e miratuar të kompensimit financiar.

## 240 PERFITUESIT E TAPIVE

| Nr. rendor | Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | | | Gjendja juridike (pronesia) | Pjesa takuese në parcelë ($m^2$) | Sipërfaqja për kalim pronësie ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Leja e legalizimit | | | | |
| | | | | Numer | Date | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 1 | DILAVER | DEMIR | LEKA | 9999981 | 11/8/2016 | SHTETERORE | | 142.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2116 | | | | | | | | |
| 2 | BUJAR | NAZIF | LARAKU | 9595505 | 2/8/2016 | SHTETERORE | | 294 |
| 3 | PANAJOT | XHETAN | DURBAKU | 1020775 | 19/11/2016 | SHTETERORE | | 204.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2248 | | | | | | | | |
| 4 | XHEVAT | NEXHIP | HOXHA | 9998910 | 11/8/2016 | SHTETERORE | | 220 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2924 | | | | | | | | |
| 5 | VASIL | ESTREF | BELBA | 3004028 | 18/08/2016 | SHTETERORE | | 390.6 |
| 6 | HAXHI | SHABAN | ÇUKA | 3030719 | 15/03/2017 | SHTETERORE | | 119 |
| | RIFAT | HYQMET | HASBALLA | | | | | |
| | HURMA | SADIK | HASBALLA | | | | | |
| 7 | ARSEMIN | MUHARREM | LULI | 4050036 | 19/12/2016 | SHTETERORE | | 126 |
| 8 | LUAN | SEIT | BELBA | 2096858 | 9/2/2017 | SHTETERORE | | 1020.5 |
| 9 | SALI | RIFAT | KAMPULA | 3040557 | 16/12/2016 | SHTETERORE | | 402 |
| | YLLI | SALI | KAMPULA | | | | | |
| | ARIAN | SALI | KAMPULA | | | | | |
| | FATOS | SALI | KAMPULA | | | | | |
| 10 | LEFTER | PETRIT | VASKU | 7070025 | 29/12/2016 | SHTETERORE | | 60 |
| 11 | QANI | HAJREDIN | BARDHI | 3003018 | 13/08/2016 | SHTETERORE | | 175.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2925 | | | | | | | | |
| 12 | ARJAN | DAUT | KOKONOZI | 3040116 | 24/08/2016 | SHTETERORE | | 395.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3683 | | | | | | | | |
| 13 | LATIF | JASHAR | TOÇKA | 9974385 | 9/7/2016 | SHTETERORE | | 200 |
| 14 | EDUART | BEDRI | TOÇKA | 7575018 | 22/07/2016 | SHTETERORE | | 220 |
| 15 | ARJAN | DEMIRALI | BALLA | 7070042 | 31/12/2016 | SHTETERORE | | 149.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 1195 | | | | | | | | |
| 16 | BLENTI | BAKI | SINANI | 302070 | 2/2/2017 | SHTETERORE | | 20.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2393 | | | | | | | | |
| 17 | ILIR | SHEFQET | TABAKU | 7745314 | 29/03/2016 | SHTETERORE | | 323.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2892 | | | | | | | | |
| 18 | BARDHOSH | SHABAN | META | 5758046 | 15/10/2016 | SHTETERORE | | 441.6 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2908 | | | | | | | | |
| 19 | KUJTIM | MUSTAFA | KRUJA | 3030866 | 20/03/2017 | SHTETERORE | | 91.5 |
| 20 | BLEDAR | VISERJAN | ZYBA | 8080252 | 25/01/2017 | SHTETERORE | | 72.7 |
| | ELIONA | VISERJAN | CANI | | | | | |
| | VIOLETA | MIHAL | ZYBA | | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1258 | | | | | | | | |
| 21 | KOSTA | HASAN | LALA | 9595201 | 5/4/2017 | SHTETERORE | | 58.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1303 | | | | | | | | |
| 22 | OSMAN | RIZA | LLESHANAKU | 7896526 | 15/04/2016 | SHTETERORE | | 500 |
| | SOKOL | OSMAN | LLESHANAKU | | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1742 | | | | | | | | |
| 23 | AVRAM | STEFAN | BINJAKU | 102026 | 6/3/2017 | SHTETERORE | | 98.7 |
| 24 | AVRAM | STEFAN | BINJAKU | 102021 | 6/3/2017 | SHTETERORE | | 120.3 |
| 25 | AVRAM | STEFAN | BINJAKU | 102027 | 6/3/2017 | SHTETERORE | | 500 |
| 26 | AVRAM | STEFAN | BINJAKU | 102028 | 6/3/2017 | SHTETERORE | | 500 |
| 27 | PULLUM | SOKRAT | OGA | 1030312 | 22/11/2016 | SHTETERORE | | 319.5 |
| 28 | LEON | ANDON | SHQAU | 405005 | 4/2/2017 | SHTETERORE | | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2124 | | | | | | | | |
| 29 | GËZIM | RAMAZAN | SALLA | 719180 | 14/04/2017 | SHTETERORE | | 567 |
| | MERITA | PETRIT | SALLA | | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2654 | | | | | | | | |
| 30 | TOMORR | SHEFQET | KALIA | 4020924 | 12/12/2016 | SHTETERORE | | 244.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8525 | | | | | | | | |
| 31 | BEDRI | TELHA | RADOVICKA | 9595102 | 5/10/2016 | SHTETERORE | | 81.6 |
| | LUMTURI | ZAIM | RADOVICKA | | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8526 | | | | | | | | |
| 32 | ALBJON | RIZA | MALJA | 202096 | 28/01/2017 | SHTETERORE | | 150.4 |
| 33 | RIZA | NEXHIP | MALJA | 202095 | 27/01/2017 | SHTETERORE | | 250.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2696 | | | | | | | | |
| 34 | GENTIAN | HYSEN | SHOPI | 9595027 | 8/10/2016 | SHTETERORE | | 2763.6 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1407 | | | | | | | | |
| 35 | NDRIÇIM | ASLLAN | KUQJA | 798024 | 13/02/2017 | SHTETERORE | | 1134.8 |
| | BEHAR | ASLLAN | KUQJA | | | | | |
| 36 | BEHAR | ASLLAN | KUQJA | 798025 | 13/02/2017 | SHTETERORE | | 162.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3633 | | | | | | | | |
| 37 | BLERIM | JAHJA | HASANI | 1020040 | 10/1/2017 | SHTETERORE | | 202 |
| 38 | DASHNOR | JAHJA | HASANI | 1020014 | 10/1/2017 | SHTETERORE | | 312 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1258 | | | | | | | | |
| 39 | RIZA | SABRI | TAFA | 669853154 | 30/01/2016 | SHTETERORE | | 844.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2654 | | | | | | | | |
| 40 | ANDREA | IBRAHIM | HIDA | 7070037 | 31/12/2016 | SHTETERORE | | 411.6 |
| 41 | ADRIATIK | FAIK | LARAJ | 4040427 | 19/12/2016 | SHTETERORE | | 114.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3376 | | | | | | | | |
| 42 | GAZMIR | SELIM | KUMURIJA | 6060439 | 31/10/2016 | SHTETERORE | | 295.8 |
| 43 | ARDJAN | SELIM | KUMURIJA | 6060410 | 28/10/2016 | SHTETERORE | | 285 |
| 44 | ARDIAN | QERIM | LLESHI | 4050088 | 21/12/2016 | SHTETERORE | | 411.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3633 | | | | | | | | |
| 45 | ENRIK | AGUSH | GURABARDHI | 300073 | 28/03/2017 | SHTETERORE | | 297.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3764 | | | | | | | | |
| 46 | KAMER | RIZA | ÇELA | 505005 | 27/04/2017 | SHTETERORE | | 204.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8523 | | | | | | | | |
| 47 | ADMIR | SYRJA | ELEZI | 7171905 | 27/02/2017 | SHTETERORE | | 26.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8525 | | | | | | | | |
| 48 | EDMOND | SHEFQET | DISHA | 305096 | 27/03/2017 | SHTETERORE | | 371.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8527 | | | | | | | | |
| 49 | HEKURAN | RAMAZAN | SHORJA | 9987608 | 4/4/2016 | SHTETERORE | | 469.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 1063 | | | | | | | | |
| 50 | ARBEN | FEZULLA | SHPATA | 6669855 | 25/01/2016 | SHTETERORE | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 1443 | | | | | | | | |
| 51 | FATMIR | GANI | ÇEKREZI | 779965 | 1/3/2016 | SHTETERORE | | 106.8 |
| 52 | LAVDIM | SABRI | HILA | 776614 | 30/04/2016 | SHTETERORE | | 306 |
| 53 | MEHDI | XHELADIN | OMERI | 9999507 | 8/8/2016 | SHTETERORE | | 300 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 1652 | | | | | | | | |
| 54 | BEDRI | HAZIZ | BALAZI | 9985985 | 29/06/2016 | SHTETERORE | | 193 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 1821 | | | | | | | | |
| 55 | ABDULLA | VEIZ | SKODI | 7785327 | 28/04/2016 | SHTETERORE | | 261 |
| 56 | SAFET | SHABAN | ALIMETA | 9974869 | 12/7/2016 | SHTETERORE | | 500 |
| | ARTAN | SHABAN | ALIMETA | | | | | |
| 57 | NAIM | QAZIM | ALIMETA | 77965467 | 28/04/2016 | SHTETERORE | | 333 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2446 | | | | | | | | |
| 58 | LUAN | IDRIS | MURATI | 9999856 | 8/8/2016 | SHTETERORE | | 55.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2696 | | | | | | | | |
| 59 | GAZMIR | ABDULLA | HOXHA | 7796533 | 28/04/2016 | SHTETERORE | | 274 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3020 | | | | | | | | |
| 60 | YLBER | GANI | ZAIMI | 9595105 | 5/10/2016 | SHTETERORE | | 176.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3859 | | | | | | | | |
| 61 | FAIK | SHERIF | ALLIU | 9696008 | 6/8/2016 | SHTETERORE | | 247.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Gramsh, ZONA KADASTRALE 1842 | | | | | | | | |
| 62 | SABRI | CAUSH | SENJA | 3040274 | 29/08/2016 | SHTETERORE | | 45.6 |
| | MEREME | DEMIR | SENJA | | | | | |
| | MERITA | SABRI | RAMA | | | | | |
| 63 | ERVIS | HETEM | JONUZI | 3040081 | 23/08/2016 | SHTETERORE | | 218.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Gramsh, ZONA KADASTRALE 2967 | | | | | | | | |
| 64 | ARDIAN | GANI | SINANI | 4040419 | 10/12/2016 | SHTETERORE | | 141.6 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2924 | | | | | | | | |
| 65 | LUAN | RAMADAN | KARRIQI | 3050809 | 21/03/2017 | SHTETERORE | | 227.1 |
| 66 | ILIA | TAHIR | KARRIQI | 3030630 | 18/03/2017 | SHTETERORE | | 339 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3683 | | | | | | | | |
| 67 | XHEVAIR | SABRI | RIRA | 3030352 | 19/01/2016 | SHTETERORE | | 75 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2696 | | | | | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 68 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040101 | 24/08/2016 | SHTETERORE | | 1156.4 |
| 69 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040122 | 24/08/2016 | SHTETERORE | | 112.4 |
| 70 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040121 | 24/08/2016 | SHTETERORE | | 24.4 |
| 71 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040098 | 24/08/2016 | SHTETERORE | | 131.2 |
| 72 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040135 | 25/08/2016 | SHTETERORE | | 77.5 |
| 73 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040100 | 24/08/2016 | SHTETERORE | | 353.5 |
| 74 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040099 | 24/08/2016 | SHTETERORE | | 46.4 |
| 75 | GEGA-G SH.P.K | | | 3040136 | 25/08/2016 | SHTETERORE | | 182.3 |
| ***QARKU ELBASAN , ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 2441*** | | | | | | | | |
| 76 | BARDHUL | MEZAN | BAJRAMI | 9985215 | 23/06/2016 | PRONARE | | 334.2 |
| 77 | BARDHUL | MEZAN | BAJRAMI | 9985215 | 23/06/2016 | PRONARE | | 21.3 |
| 78 | YMER | NEXHIP | HYSA | 9985213 | 23/06/2016 | PRONARE | | 347.7 |
| **DREJTORIA E ALUIZNI-t KORÇË** | | | | | | | | |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8563*** | | | | | | | | |
| 79 | BESNIK | NEKI | MYRTO | 160773 | 22.04.2017 | Shtetërore | | 37.4 |
| 80 | LIRIM | MEHMET | MYRTOLLARI | 160849 | 22.05.2017 | Shtetërore | | 654.4 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 3637*** | | | | | | | | |
| 81 | Myftinia Korçe (Xhamia Tren) | | | 160788 | 25/04/2017 | Shteti | | 369.5 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8561*** | | | | | | | | |
| 82 | HYQMET | MUHAREM | DAUTI | 1121904 | 26/01/2017 | PPV+SHTET | | 118.4 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8562*** | | | | | | | | |
| 83 | PAOLA<br>ORNELA | ZEQIR<br>VLADIMIR | ÇOÇKA<br>ÇAUSHLLARI | 160689 | 20.03.2017 | Shtetërore | | 216.77 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 2573*** | | | | | | | | |
| 84 | AGRON<br>FABIO | TOMOR<br>TOMOR | METEGJATA<br>METEGJATA | 160717 | 10/4/2017 | Shtetërore | | 200 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 1187*** | | | | | | | | |
| 85 | ZAMIR | HAMDI | SOXHUKU | 160775 | 24/04/2017 | Shtetërore | | 456 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 1187*** | | | | | | | | |
| 86 | Myftinia Korçe (Xhamia Bilisht) | | | 160784 | 25/04/2017 | Shteti | | 660 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8563*** | | | | | | | | |
| 87 | BESNIK<br>KREUZA | PETRIT<br>SOTIR | SULI<br>ANDREA | 160848 | 22.05.2017 | Shtetërore | | 926.9 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 1228*** | | | | | | | | |
| 88 | ALMA<br>KLODIANA<br>ANULA | ARGJIR | PINO<br>DEDA<br>NGJELE | 160845 | 19.05.2017 | Shtetërore | | 810.6 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8563*** | | | | | | | | |
| 89 | YLLI<br>KRISTINA<br>SOTIR | MUHAREM<br>PIRO<br>ARBEN | FETO<br>PARAVANI<br>ILIA | 160844 | 19.05.2017 | Shtetërore | | 1574 |
| ***QARKU KORÇË , ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8562*** | | | | | | | | |
| ~~90~~ | ~~Ferat~~ | ~~Ajri~~ | ~~LATOLLARI~~ | ~~160574~~ | ~~20/12/2016~~ | ~~E TË TRETËVE~~ | | ~~214~~ |
| **DREJTORIA E ALUIZNI-t TIRANA VERI** | | | | | | | | |
| ***QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8310, ZVRPP TIRANE*** | | | | | | | | |
| 91 | ELHAME | VESEL | ALLARAJ | 997302 | 24/04/2017 | Shtetërore | | 333 |
| 92 | MAHMUT | HILMI | ALLARAJ | 997301 | 24/04/2017 | Shtetërore | | 151.8 |
| 93 | HASAN | MAHMUT | ALLARAJ | 997306 | 24/04/2017 | Shtetërore | | 277 |
| ***QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8330, ZVRPP TIRANE*** | | | | | | | | |
| 94 | FERIDE | RUSTEM | KIKA | 996500 | 3/2/2017 | Shtetërore | | 354 |
| ***QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8120, ZVRPP TIRANE*** | | | | | | | | |
| 95 | SABRI | BILAL | LAMA | 997019 | 27/03/2017 | PPV | | 245.4 |
| | FRANS | GANI | GJILLANI | 91377 | 27/04/2016 | E te treteve | | 15.9 |
| **DREJTORIA E ALUIZNI-t TIRANA JUG** | | | | | | | | |
| ***QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3866*** | | | | | | | | |
| 97 | QEMAL | SURIA | LUZI | 2621559 | 28.07.2016 | SHTETERORE | | **278.1** |
| 98 | JONUS | BARI | MECI | 2126556 | 16.01.2017 | SHTETERORE | | **290** |
